

# Udhëzim

**për zbatimin e njëjësuar të kumulimit  
të plotë dhe tërheqjes nga detyrimet  
doganore midis Palëve të CEFTA-s**

Të dhënat e botimit  
Botuar nga  
Deutsche Gesellschaft für  
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH  
Selia  
Bonn dhe Eschborn, Gjermani

Fondi i Hapur Rajonal për Evropën Juglindore – Tregtia e jashtme (ORF FT)  
Zmaja od Bosne 7- 7a  
71000 Sarajevo  
T: 00387 33 957 500  
F: 00387 33 957 500  
GIZ-BosnienHerzegowina@giz.de  
www.giz.de

Në  
maj 2019

Grafika  
TDP Sarajevë

Teksti  
Branka Tudjen

GIZ-i është përgjegjës për përmbajtjen e këtij botimi.

Për llogari të  
Ministrisë Federale gjermane për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

## Përmbajtja

Akronimet/Shkurtimet e përdorura: .....	5
Shënim i përgjithshëm.....	5
Përkufizime: .....	6
1 Hyrje .....	9
2 Konteksti .....	11
3 Përkufizimi i konceptit.....	12
4 Vështrim i përgjithshëm – KUMULIMI.....	13
4.1 Llojet e kumulimit: .....	13
4.1.1 Kumulimi dypalësh .....	14
4.1.2 Kumulimi diagonal .....	16
4.1.3 Kumulimi i plotë.....	20
5 Specifikat e kumulimit të plotë në Palët e CEFTA-s .....	22
5.1 Zbatimi i kufizuar i përjashtimeve .....	22
5.1.1 Ç’vërtetim origjine duhet lëshuar?.....	24
5.2 Deklarata e furnitorit (DF) .....	25
5.2.1 Deklarata e furnitorit (për një ngarkesë) .....	26
5.2.2 Deklarata afatgjatë e furnitorit .....	26
5.2.3 Plotësimi i deklaratës së furnitorit .....	28
5.2.4 Ruajtja e deklaratave të furnitorit dhe dokumenteve mbështetëse .....	31
5.2.5 Bashkëpunimi administrativ dhe verifikimi i deklaratave të furnitorit .....	31
5.2.6 Pasojat e deklaratës së pasaktë të furnitorit .....	33
5.3 Shembull i kumulimit të plotë – rregulli i vlerës së shtuar .....	34
5.4 Shembull i kumulimit të plotë – rregulli i procesit/process rule .....	38
6 Vështrim i përgjithshëm – tërheqja nga detyrimi doganor .....	40
6.1 Ndalimi i tërheqjes nga detyrimet doganor (rregulli i mostërheqjes) .....	40
6.1.1 Konventa PEM dhe NDDB-ja.....	40
6.2 CEFTA dhe DDB-ja .....	41
6.3 Shembulli – rregulli i “mostërheqjes” kundrejt atij të “tërheqjes” nga detyrimet doganore .....	41
6.4 Kumulimi i plotë dhe tërheqja nga detyrimi doganor .....	44

Anekset: .....	46
SHTOJCA 1: Shtojca II – Pasqyra e lëndës pas përfshirjes së Vendimit 2/20177 ...	47
SHTOJCA 2: Instrumentet ekzistuese – Faqet e internetit .....	49
SHTOJCA 3: Formulari i deklaratës së furnitorit .....	50
SHTOJCA 4: Formulari i deklaratës afatgjatë të furnitorit .....	52

## Shënim i përgjithshëm

Ky dokument udhëzues ka karakter shpjegues dhe ilustrues dhe përmban informacione mbi mundësinë e kumulimit të plotë dhe DDB-së në palët e CEFTA-s. Legjislacioni doganor merr përparësi në raport me përmbajtjen e këtij dokumenti e duhet konsultuar gjithnjë së bashku me dispozitat e Protokollit të Originës që përkojnë me MTL-në.

### Akronimet/Shkurtimet e përdorura:

AEX:	Eksportues i miratuar
CEFTA:	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë së Evropës Qendrore
NKT:	Ndryshimi Kodit Tarifor
DDB:	Tërheqja nga detyrimet doganore
EFTA:	Shoqata Evropiane e Tregtisë së Lirë
BE:	Bashkimi Evropian
EXW:	Ex Work
MTL:	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë
NK:	Nomenklatura e kombinuar e mallrave dhe kodeve bazuar në sistemin e harmonizuar tarifor
NDDB:	Rregulli i ndalimit të tërheqjes nga detyrimet doganore
Konventa PEM:	Konventa Rajonale Pan-euro-mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës
RrSP:	Rregulli specifik i origjinës së produktit
DF:	Deklarata e furnitorit
OBD:	Organizata Botërore e Doganave

## Përkufizime:

---

### **Marrëveshja e Tregtisë së Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA)<sup>1</sup>**

Marrëveshja e Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore është një marrëveshje tregtare midis vendeve joanëtare të BE-së. Marrëveshja fillestare u nënshkrua nga Polonia, Hungaria dhe Republikat Çeke dhe Sllovaqe, më 21 dhjetor 1992 në Krakov, Poloni. Ajo hyri në fuqi në korrik 1994.

Palët nënshkruese të CEFTA-s 2006 ishin Republika e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovina, Republika e Bullgarisë, Republika e Kroacisë, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Republika e Malit të Zi, Rumania, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë për llogari të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Kur një vend pjesëmarrës anëtarësohet në Bashkimin Evropian, anëtarësimi i tyre në CEFTA përfundon, ndaj Bullgaria, Rumania dhe Kroacia u tërhoqën nga CEFTA, pasi u bënë vende anëtare të BE-së.

Sot, shtetet anëtare të CEFTA-s janë vendet pjesëmarrëse në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian dhe Republika e Moldavisë. Të gjitha shtetet anëtare të CEFTA-s janë Palë Kontraktuese të Konventës PEM.

---

### **Vendimi 3/2015<sup>2</sup> i CEFTA-s**

Palët e CEFTA-s miratuan Vendimin 3/2015<sup>3</sup>, që parashikon dispozita të posaçme përjashtuese nga parashikimet që përmban Shtojca I e Konventës. Synimi i tij kryesor është të lehtësojë tregtinë midis shteteve anëtare të CEFTA-s duke lehtësuar kushtet e kumulimit të përcaktuara në Nenin 3 të Shtojcës I të Konventës PEM që lidhen me kumulimin e origjinës dhe duke shfuqizuar ndalimin e tërheqjes apo përjashtimit nga detyrimet doganore të parashikuara në Nenin 14 të Shtojcës I të Konventës PEM. Aneksi i Vendimit përbëhet nga dy Protokolle: Protokollin A mbi përkufizimin e konceptit të “produktit origjinues” e metodat e bashkëpunimit administrativ dhe Protokollin B mbi zbatimin e kumulimit të plotë dhe tërheqjes nga detyrimet doganore në CEFTA, si dhe metodat e bashkëpunimit administrativ.

---

<sup>1</sup>Të gjitha hollësitë rreth CEFTA-s mund të gjenden në adresën: <https://cefta.int/cefta-parties-2/>

<sup>2</sup>Kur teksti i referohet këtij vendimi, nënkupton Protokollin B (në rast se nuk shkruhet ndryshe).

<sup>3</sup>Vendimi i Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore Nr. 3/2015, miratuar më 26 nëntor 2015, i cili ndryshon Vendimin e Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore Nr. 3/2013 mbi Shtojcën 4 të Protokollit të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA 2006) për Përkufizimin e Konceptit të “Produkteve origjinuese” dhe Metodave të Bashkëpunimit Administrativ të përmendura në Nenin 14, paragrafi 1 dhe 3, miratuar më 20 nëntor 2013

<b>Konventa PEM ose Konventa Rajonale<sup>4</sup></b>	<p>Konventa Rajonale për rregullat preferenciale të origjinës pan-Euro-Mesdhetare<sup>5</sup> përcakton rregullat lidhur me origjinën e mallrave dhe bashkon në një instrument të vetëm ligjor të gjitha rregullat që kanë të bëjnë me origjinën e mallrave të tregtuara në kontekstin e rreth 60 marrëveshjeve të tregtisë së lirë (MTL) midis vendeve të zonës pan-euro-mesdhetare, si dhe me vendet që janë palë e Procesit të Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian. Ajo ka hyrë në fuqi më 1 janar 2012 dhe ka filluar zbatimin që nga data 26 mars 2012.</p> <p>Objektivi kryesor i Konventës është të zëvendësojë të gjitha protokollet e origjinës në marrëveshjet e tregtisë së lirë midis Palëve Kontraktuese me një protokoll të vetëm (Shtojca I e Konventës), për të pasur një grup të vetëm rregullash, që mundësojnë rishikime më të thjeshta të tekstit të rregullave të origjinës në të ardhmen.</p> <p>Aktualisht, palët nënshkruese të PEM-it janë 28 shtetet anëtare të BE-së; katër shtete të EFTA-s<sup>6</sup>; Turqia, pjesëmarrësit e PSA-së<sup>7</sup>, vendet nënshkruese të deklaratës së Barcelonës<sup>8</sup>, Ishujt Faroe, Republika e Moldavisë, Gjeorgjia dhe Ukraina.</p>
<b>Konventa e Rishikuar e PEM-it</b>	<p>Puna për rishikimin kryhet në Grupin e Punës pan-euro-mesdhetar. Procesi i rishikimit nisi në vitin 2013, për ta thjeshtuar e lehtësuar më tej. Ky procesi rishikimi që është në vazhdim synon vendosjen e rregullave më të thjeshta, më liberale, që u përgjigjen më shumë nevojave të tregtarëve.</p>
<b>Vendimi Nr. 2/2017 i PEM-it</b>	<p>Vendimi 2/2017 i Komitetit të Përbashkët të Konventës pan-Euro-Mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës, datë 16 maj 2017 (mbështetur në Vendimin 3/2015 të CEFTA-s), do të ndryshojë Shtojcën II të Konventës Rajonale Pan-Euro-Mesdhetare për rregullat preferenciale të origjinës duke futur mundësinë e tërheqjes nga detyrimet doganore dhe kumulimin e plotë në tregtinë që mbulohet nga CEFTA, ku përfshihen Republika e Moldavisë dhe pjesëmarrësit e PSA-së.</p> <p>Projektvendimi 2/2017 u miratua në takimin e 6-të të Komitetit të Përbashkët të Konventës PEM, zhvilluar në Bruksel më 16 maj 2017 nga të gjitha Palët Kontraktuese të pranishme në mbledhje.</p>

<sup>4</sup> Informacionet bazë për Konventën PEM, përfshi tekstin, një përshkrim të dispozitave kryesore, një matricë të vendeve që e zbatojnë dhe midis të cilave është i mundur kumulimi i origjinës mund t'i gjeni në: [https://ec.europa.eu/taxation\\_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin/arrangements-list/paneuromediterranean-cumulation-pem-convention\\_en#heading](https://ec.europa.eu/taxation_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin/arrangements-list/paneuromediterranean-cumulation-pem-convention_en#heading)

<sup>5</sup> Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian L 54, 26.2.2013, f. 4.

<sup>6</sup> Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia, Zvicra

<sup>7</sup> Procesi i Stabilizim-Asociimit (PSA) është politika e Bashkimit Evropian ndaj Ballkanit Perëndimor, i krijuar me synim përfundimtar anëtarësimin në BE - [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/sap\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/policy/glossary/terms/sap_en).

<sup>8</sup> Algjeria, Egjipti, Jordania, Libani, Maroku, Autoriteti Palestinez, Siria, Tunizia dhe Turqia

<b>Matrica e PEM-it</b>	Që kumulimi diagonal të zbatohet nga Palët Kontraktuese të PEM-it, ai duhet botuar në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian (seria C) dhe në territorin e Palës tjetër, në përputhje me procedurën e saj. Ky informacion përmbledhet dhe paraqitet në Tabelat 1-3, përmendur si “matrica” <sup>9</sup> . Tabelat 1 dhe 2 gjejnë zbatim për kumulimin, sipas Konventës Rajonale dhe Tabelës 3 të kumulimit të PSA-së.
<b>Rregullat e listës / RrSP</b>	Çdo MTL ka një shtojcë që përmban listën e punimit ose përpunimit të nevojshëm për t’u kryer në materialet joorigjinuese, me qëllim që produkti i prodhuar të përfitojë statusin origjinues.  Rregullat e listës njihen gjithashtu si Rregullat Specifike të Origjinës së Produktit (RrSP) përcaktojnë sesa punim dhe përpunim duhet kryer mbi materialet joorigjinuese të një produkti, me qëllim që produkti i përfunduar të përfitojë statusin origjinues (punim ose përpunim i mjaftueshëm i materialeve joorigjinuese).
<b>Operacion minimal</b>	Operacione të pamjaftueshme (d.m.th., paketimi, prerja e thjeshtë, montimi i thjeshtë, përzjerja e thjeshtë etj.), të përmendura shpesh si operacione minimale. Operacionet minimale janë ato që, kur kryhen qoftë individualisht apo në kombinim, konsiderohen me rëndësi kaq të vogël, sa nuk e japin kurrë statusin origjinues. Punimi ose përpunimi i pamjaftueshëm renditet në Nenin 6 të Konventës PEM. Operacionet minimale janë të përfshira në rregullat e origjinës në dy situata: <ul style="list-style-type: none"> <li>• Pavarësisht përmbushjes së kushteve të listës së rregullave, të gjitha rregullat preferenciale përmbajnë një listim të punimit ose përpunimit që është i pamjaftueshëm për dhënien e origjinës.</li> <li>• Po kështu, për të zbatuar çdo lloj kumulimi, procesi i punimit ose përpunimit duhet të jetë më shumë se i pamjaftueshëm.</li> </ul>
<b>Tërheqja nga detyrimet doganore (DDB)</b>	Termi “tërheqje” i referohet heqjes dorë ose rimbursimit të detyrimit doganor mbi importin për materialet e përdorura në prodhimin e një produkti për eksport.
<b>Mostërheqja nga detyrimet doganore (NDDB)</b>	Ndalimi për t’u tërhequr apo përjashtuar nga detyrimet doganore.  Në disa grupe rregullash të origjinës ka një dispozitë që nuk lejon zbatimin e sistemeve të tërheqjes nga detyrimet doganore për materialet që përdoren për prodhimin e një malli që ka për qëllim përfitimin e trajtimit preferencial në vendin e importit, d.m.th., rregulli i ndalimit të tërheqjes.
<b>Deklarata e furnitorit (DF)</b>	Deklarata e furnitorit është deklarata e paraqitur nga furnitorët, që përmban të dhëna për klientët lidhur me statusin e origjinës së mallrave.  Furnitori është personi që kontrollon dhe ka njohuri mbi statusin e origjinës së mallrave, pavarësisht faturimit.

<sup>9</sup> P.sh., Fletorja Zyrtare e BE-së 2018/C 325/06, datë 14.09.2018



## 1 Hyrje

Ky udhëzues për kumulimin e plotë dhe parimin e tërheqjes nga detyrimet doganore përshkruan mundësitë që, sipas Vendimit të CEFTA-s, do të përdoren mes palëve të CEFTA-s.

Duke qenë se kumulimi i plotë është më pak kufizues dhe ka rregulla më elastike sesa kumulimi dypalësh e diagonal që janë më të përhapur, ai lejon ndarjen e produkteve brenda territorit të MTL-së, një fragmentim më të madh të procesit të prodhimit dhe mund të sjellë përfitime nga transaksionet e biznesit dhe nxitje më të madhe të tregtisë. Në përfundim, kjo mund të çojë në zgjerimin e tregtisë në zonë.

Ndalimi i tërheqjes nga detyrimi doganor, që përdoret aktualisht në MTL-të që zbatojnë shtetet anëtare të CEFTA-s, ul përfitimin maksimal që mund të pritët nga uljet e tarifave për të cilat është rënë dakord në kuadrin e një MTL-je.

- Ai mund të krijojë shtrebbërime konkurruese midis palëve pjesëmarrëse, si rrjedhojë e konkurrencës së pandershme, kur palët partnere brenda një zone të tregtisë së lirë zbatojnë regjime të jashtme të tarifave doganore, që kanë ndryshim shumë të madh.
- Po kështu, kjo ka krijuar burokraci për operatorët ekonomikë, të cilët duhet të vendosin se cili është sistemi i preferuar për secilin produkt dhe destinacion. Kjo nënkupton që eksportuesi mund të vendosë të zbatojë tërheqjen nga detyrimi doganor dhe t'i shesë mallrat pa origjinën preferenciale, çka çon në përlogaritjen e detyrimit doganor në vendin e importimit ose eksportuesi mund të paguajë detyrim doganor për materialet e një vendi të tretë që ka përdorur në prodhim dhe të lejojë që marrësi në vendin partner të përfitojë nga preferencat tarifore mbi importin.

Nga ana tjetër, mundësia për të mos paguar apo rimbursuar detyrimet doganore (tërheqja nga detyrimi doganor) mund të ndihmojë për krijimin e mundësive reale midis operatorëve ekonomikë në mbarë zonën e tregtisë së lirë.

Për t'i bërë shoqëritë tregtare të përfitojnë plotësisht nga kumulimit dhe DDB-ja, është e nevojshme të kuptohen të gjitha funksionet që kanë këto instrumente, si dhe të gjitha aspektet pozitive e negative. Po kështu, administratat doganore duhet të kuptojnë dhe promovojnë avantazhet që kanë këto instrumente, si dhe të ushtrojnë kontrollin e duhur mbi zbatimin e tyre.

Keqkuptimi lidhur me zbatimin e duhur të kumulimit të plotë dhe tërheqjes nga tarifatat mund të çojnë në pasiguri në përftimin e origjinës preferenciale dhe të ndikojnë në vlerën e tarifave që do të paguhet dhe, për rrjedhojë, në çmimin fundor të produktit.

Objektivat e këtyre udhëzimeve janë:

- Të kuptohet qartë nga biznesi dhe doganat mundësia e kumulimit të plotë dhe tërheqjes të tarifave midis Palëve të CEFTA-s;

- Harmonizimi i praktikave kombëtare dhe rajonale në fushën e kumulimit dhe tërheqjes nga detyrimet doganore;
- Ndarja e njohurive në shkallë rajonale dhe përhapja e praktikave më të mira përmes seminareve rajonale, mbështetur në këtë udhëzues.

## 2 Konteksti

Konventa PEM përcakton dispozitat mbi origjinën e mallrave të tregtuara në bazë të marrëveshjeve përkatëse të lidhura midis Palëve Kontraktuese.

Konventa PEM, që është aktualisht në zbatim, parashikon kumulim dypalësh dhe diagonal, ndërkohë që kumulimi i plotë mund të përdoret midis disa palëve, si pjesë e përjashtimeve nga rregullat e përgjithshme të kumulimit.

Konventa e rishikuar PEM (si objektivi i procesit të vazhdueshëm të rishikimit) parashikon, po ashtu, mundësinë e përdorimit të kumulimit të plotë dypalësh dhe diagonal<sup>10</sup> me disa përjashtime dhe mundësi.

Me të njëjtin synim, Komiteti i Përbashkët i CEFTA-s, me anë të Vendimit 3/2015, datë 26 nëntor 2015, që ndryshon Protokollin e Origjinës së Marrëveshjes CEFTA, ka përfshirë mundësinë e tërheqjes nga detyrimi doganor dhe të kumulimit të plotë në tregtinë midis Palëve të CEFTA-s<sup>11</sup>.

Duhet theksuar se të gjitha Palët e CEFTA-s janë palë kontraktuese të Konventës.

Më 25 maj 2016, Komisioni i BE-së, në cilësinë e sekretariatit të Komitetit të Përbashkët të PEM-it, morri një letër informuese rreth Vendimit Nr. 3/2015 të CEFTA-s përmendur me lart.

Duhet marrë parasysh se Neni 1 i Shtojcës II të Konventës PEM u jep mundësi Palëve Kontraktuese që të zbatojnë në marrëveshjet e tyre tregtare dypalëshe dispozita të posaçme, që i përjashtojnë nga dispozitat e parashikuara në Shtojcën I. Po ashtu, këto dispozita të posaçme duhet të jenë të përcaktuara në Anekset e kësaj Shtojce. Kjo nënkupton se përjashtimet nga Shtojca I që mund të zbatohen nga Palët Kontraktuese janë të kufizuara, sipas atyre të përcaktuara në Anekset e Shtojcës II.

Futja e përjashtimeve të reja në Shtojcën II kërkon ndryshimin e kësaj Shtojce, e cila duhet miratuar njëzëri nga Komiteti i përbashkët i Konventës PEM. CEFTA ka rënë dakord me analizën ligjore dhe e ka ftuar sekretariatit të vijojë punën në përputhje me të. Mbështetur në Vendimin e Komitetit të Përbashkët të CEFTA-s, Komisioni Evropian ka përgatitur një projektvendim të ri dhe ia ka paraqitur për votim Komitetit të Përbashkët. Në mbledhjen e gjashtë të Komitetit të Përbashkët të Konventës PEM, zhvilluar në Bruksel, më 16 maj 2017, projektvendimi u miratua nga të gjitha Palët Kontraktuese të Pranishme në takim. Po kështu, palët e CEFTA-s duhet të rishikojnë edhe procedurat e brendshme, duke qenë se dispozitat në fjalë ndërhyjnë në vlerat e tarifave doganore dhe detyrimeve të pagueshme.

<sup>10</sup> Procesi i rishikimit të Konventës PEM nisi në vitin 2013 dhe ende nuk ka përfunduar. Teksti i propozuar në Konventën e Rishikuar PEM ruan kumulimin diagonal për të gjitha produktet dhe kumulimin e plotë të përgjithshëm e tërheqjen nga detyrimet doganore për të gjitha produktet, me përjashtim të tekstileve dhe veshjeve në Kapitujt 50-63. Për produktet në Kapitujt NK 50-63, ai ofron mundësinë kumulimit të plotë dhe tërheqjes nga detyrimet doganore mbi baza dypalëshe. Po kështu, Palët kontraktuese kanë alternativë ta zgjerojnë kumulimin e plotë të përgjithshëm për produktet e tyre të importit nga Kapitujt 50-63.

<sup>11</sup> Vendimi 3/2015 i CEFTA-s ishte pikënisja për këtë Udhëzues.

### 3 Përkufizimi i konceptit

Në tregtinë ndërkombëtare të mallrave, për të gjitha mallrat e importuara në vendin e importit, vlera e tarifave të KMF-së (kombi më i favorizuar – shënim i përkthyesit) paguhet kur mallrat nxirren në qarkullim të lirë. Falë MTL-ve, mallrat mund t'i nënshtrohen një trajtimi tarifor preferencial (në rast se përmbushin disa kritere të përcaktuara dhe nëse në vendin e eksportit lëshohet vërtetimi përkatës i origjinës). Këto kritere përcaktohen nga rregullat e origjinës, që janë pjesë përbërëse e Protokolleve të origjinës të MTL-së.

Origjina përcakton kombësinë e një produkti. Vendimi për të zbatuar ose jo trajtimin tarifor preferencial mbështetet po kështu tek origjina. Për marrjen e statusit preferencial origjinues, rregullat preferenciale përcaktojnë dy kritere kryesore:

- produkte tërësisht të përftuara, ku ka vetëm një vend të përfshirë në prodhimin e produktit (ose të materialeve dhe produkteve);
- produkte të punuara ose të përpunuara në masë të mjaftueshme, në procesin e prodhimit të cilave përfshihen dy ose më shumë vende dhe materialet e përdorura për prodhimin e këtyre produkteve i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në masë të mjaftueshme. Punimi ose përpunimi i nevojshëm që duhet për përfundimin e origjinës preferenciale të produktit përfundimtar përcaktohen nga lista e rregullave (RrSP).

Kumulimi është një dispozitë e cila lejon që mallrat e përftuara ose përpunimi i kryer në vend anëtar të MTL-së të konsiderohet si origjinues në një vend tjetër. Në këtë kontekst, ai lejon përdorimin e materialeve nga furnitorët që gjenden në vendet partnere të MTL-së dhe i trajton ato si materiale origjinuese, për të përcaktuar origjinën e produktit përfundimtar apo për të përfshirë një proces prodhimi të kryer në hapësirën e MTL-së. Kjo është një prej mënyrave për t'iu siguruar prodhuesve më shumë fleksibilitet lidhur me burimet e materialeve. Kumulimi forcon integrimin ekonomik dhe bashkëpunimin industrial midis vendeve partnere.

Përveç kumulimit dypalësh dhe diagonal (si parim i zakonshëm i kumulimit), ka edhe forma të tjera kumulimi, p.sh., kumulimi rajonal, i plotë dhe i zgjeruar. Kumulimi i plotë, i cili është edhe tema e këtij udhëzuesi, është një lloj kumulimi i zbatuar tashmë midis disa grupeve të palëve kontraktuese në zonën PEM, por është një mundësi e re për Palët e CEFTA-s.

Termi tërheqje nga detyrimi doganor i referohet heqjes dorë apo rimbursimit të detyrimeve doganore mbi importin për materialet e përdorura për prodhimin e një produkti për eksport. Ai bën të mundur që të mos paguhet tarifat e importit ose të rimarrjen e detyrimeve doganore që janë paguar në import për materialet e përdorura për përpunim të mëtejshëm, ndërkohë që malli përfundimtar për të cilin përdoren këto materiale eksportohet.

Në disa grupe rregullash të origjinës ka një dispozitë që nuk lejon zbatimin e sistemeve të DDB-së për materialet e importuara që përdoren për prodhimin e mallrave që synojnë përfitimin e trajtimit preferencial në vendin e importit, d.m.th., rregulli i ndalimit të tërheqjes nga detyrimi doganor.

## 4 Vështrim i përgjithshëm – KUMULIMI

Kumulimi është devijim nga rregullat e përgjithshme të origjinës. Në kuadrin e marrëveshjeve preferenciale të tregtisë, ai është një lehtësim që ndihmon mallrat e prodhuara të plotësojnë rregullin përkatës të origjinës. Kumulimi funksionon duke i mbledhur vendet në grupe apo zona për qëllime origjine. Kjo i lejon prodhuesit t'i konsiderojnë materialet e përpunuara ose që e kanë origjinën nga vendet e tjera të zonës së kumulimit si të ishin të përpunuara apo me origjinë nga vendet e prodhimit, kur bëhen pjesë e një produkti të bërë aty.

Në shumicën e rasteve, që kumulimi të zbatohet midis dy vendeve, duhen plotësuar dy kushte<sup>12</sup>:

- Ekzistenca e MTL-së midis vendeve që duan të kumulojnë origjinën dhe
- Duhet të ketë rregulla identike të origjinës në zonën e kumulimit.

Normalisht, për të përfutur origjinën preferenciale të vendit eksportues, produkti duhet ose të jetë përfutur plotësisht, ose materialet e huaja hyrëse (materiale joorigjinuese) duhet të jenë punuar apo përpunuar në vendin eksportues. Kumulimi ndryshon përkufizimin e atij çka konsiderohet material joorigjinues dhe i ndihmon eksportuesit të përftojnë statusin e origjinës për mallrat. Në rast kumulimi, punimi ose përpunimi i kryer në secilin vend partner nuk duhet të jetë i mjaftueshëm. Mjafton që këto operacione të kalojnë përtej punimit ose përpunimit të pamjaftueshëm<sup>13</sup>.

### 4.1 Llojet e kumulimit:

Ka tri lloje kumulimi:

- dypalësh,
- diagonal/rajonal dhe
- i plotë.

Dallimi kryesor midis këtyre tri llojeve të kumulimit është numri i palëve të përfshira (dy ose më shumë) dhe llojet e materialeve hyrëse (*inputs*) (origjinuese ose joorigjinuese), që mund të përdoren si bazë për kumulimin.

Duhet përmendur se kumulimi i plotë mund të jetë edhe dypalësh ose diagonal, në varësi të numrit të palëve të përfshira në të.

Disa MTL përfshijnë mundësinë e kumulimit me palët e treta, i ashtuquajtur *kumulim në të gjithë zonën ose i zgjeruar*. Ai lejon çdo lloj kumulimi të përmendur më lart (më shumë, atë dypalësh dhe diagonal) midis vendeve që nuk kanë lidhur marrëveshje tregtare apo

<sup>12</sup> Për zbatimin e kumulimit diagonal në Konventën PEM ka edhe një kusht të tretë – botimi i mundësisë së kumulimit në Fletoren Zyrtare të Komisionit

<sup>13</sup> Neni 6 i Konventës PEM – punimi ose përpunimi i pamjaftueshëm ose i ashtuquajtur i operacion minimal

që lidhen me anë të një marrëveshje tregtare me rregulla të ndryshme origjine. Kjo lejon përdorimin e materialeve përbërëse nga një vend i tretë që nuk është anëtar i MTL-së në fuqi dhe i konsideron ato origjinuese, nëse përmbushin rregullat e origjinës të parashikuara në marrëveshjen tregtare përkatëse. Kumulimi i zgjeruar është lloji më fleksibel i kumulimit të materialeve përbërëse origjinuese dhe, shpesh, përmban disa kufizime (kufizim për disa kapituj, nënkapituj ose kode tarifore ose për vetëm disa lloje produktesh<sup>14</sup>).


#### 4.1.1 Kumulimi dypalësh

Kumulimi dypalësh është forma bazë e kumulimit, që zbatohet në të gjitha marrëveshjet preferenciale. Siç e thotë edhe emri, zbatohet midis dy vendeve që kanë marrëveshje tregtare dypalëshe dhe lejon secilën prej palëve në marrëveshje të përdorë materialin që e ka origjinën nga vendi tjetër, si të ishte i vendit të tyre, pa humbur statusin origjinues të mallit përfundimtar (parimi – *ç’është e imja është e jotja dhe ç’është e jotja është e imja*).

Mallrat e prodhuara nga materialet origjinuese në një prej palëve të MTL-së dhe të përpunuara më tej në një tjetër (prodhimi nuk duhet të jetë i punuar ose i përpunuar mjaftueshëm, por duhet të shkojë përtej operacioneve minimale), atëherë mund të eksportohen mbrapsht te pala e parë e MTL-së, në përputhje me trajtimin preferencial. Pa kumulim, vetëm materialet përbërëse që e kanë origjinën nga vendi eksportues mund të konsiderohen me status origjinues.

Duhet theksuar se vetëm materialet origjinuese që janë importuar nga vendi ku zbatohet kumulimi dhe shoqërohen me vërtetimin përkatës të origjinës konsiderohen si materiale origjinuese. Me fjalë të tjera, ato trajtohen si të vinin nga vendi i eksportit. Kjo nënkupton se eksportuesi i mallrave përfundimtare mund të punojë më pak mbi to për të përfunduar origjinën e vendit të eksportit, d.m.th., produkte që mund të përfitojnë nga preferencat tregtare kur eksportohen.


Foto 1a – Modeli i kumulimit dypalësh – materialet origjinuese nga vendi partner A konsiderohen si materiale origjinuese në vendin B



<sup>14</sup> Për më shumë informacion - <http://findrulesoforigin.org/Glossary/accum>

Po kështu, duhet theksuar se, nëse, në prodhimin e produktit përfundimtar përdoren materiale jooriginuese, ato duhet të jenë të punuara ose përpunuara mjaftueshëm, me qëllim që produkti përfundimtar të përfitojë nga dispozitat e kumulimit.

Foto 1b – Modeli i kumulimit dypalësh – me përdorimin e materialeve prodhuese nga një vend i tretë




#### 4.1.1.1. Shembulli i kumulimit dypalësh

##### Prodhimi i kapelës në Serbi (RS)/ kumulimi dypalësh

Kapelat (NK 6505) prodhohen në Serbi. Për të prodhuar kapelat, prodhuesi në Serbi ka përdorur:

- pëlhurë tekstile që e ka origjinën nga Bosnje-Hercegovina (BA) (NK 6004) dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura e kanë origjinën nga Serbia.



- Prodhimi i kapelave është më shumë sesa punim ose përpunim i pamjaftueshëm (Neni 6 i Konventës PEM).
- RrSP për NK 6505 përcaktonte: *Prodhim prej filli ose fibrave tekstile.*

Duke qenë se për prodhimin e kapelave prodhuesi serb përdori pëlhurë tekstile origjinuese (edhe të gjitha materialet e tjera të përdorura janë materiale origjinuese) dhe prodhimi i kapelave është më shumë se i pamjaftueshëm, plotësohet rregulli i origjinës dhe eksportuesi mund të lëshojë vërtetim origjine nga Serbia për t'u eksportuar në Bosnje-Hercegovinë.

Në situatën kur, për prodhimin e kapelave, prodhuesi përdor pëlhurë jooriginuese (p.sh., pëlhurë tekstile indiane), nuk mund të plotësohet rregulli, “*Prodhim prej filli ose fibrave tekstile*” dhe kapelat do të ishin mallra jooriginuese për eksport në Bosnje-Hercegovinë.


#### 4.1.2 Kumulimi diagonal<sup>15</sup>

Kumulimi diagonal zbatohet midis Palëve Kontraktuese, të cilat kanë lidhur me njëra-tjetrën marrëveshje preferenciale, që përmbajnë rregulla identike të origjinës dhe parashikime ekzistuese për këtë kumulim. Ashtu si në rastin e kumulimit dypalësh, kumulimi diagonal mund të zbatohet vetëm për materialet që e kanë origjinën në një prej shteteve anëtare të MTL-së dhe që përpunohen më tej te një anëtar tjetër. Sidoqoftë, ndryshe nga kumulimi dypalësh, kumulimi diagonal lejon edhe që të mos kryhet punim ose përpunim në vendin eksportues dhe origjina e mallrave të ruhet.

Parimet kryesore të Konventës PEM për kumulimin diagonal janë:

- Materiali origjinues i importuar nga një Palë tjetër Kontraktuese me të cilën është i mundur kumulimi nuk duhet të jetë mjaftueshëm i punuar apo i përpunuar për të përfutur origjinën e Palës Kontraktuese eksportuese, por punimi apo përpunimi i tyre në Palën Kontraktuese eksportuese duhet të shkojë përtej operacioneve minimale.
- Nëse punimi ose përpunimi nuk shkon përtej operacioneve minimale dhe i gjithë materiali i përdorur është material origjinues<sup>16</sup>, produkti mund të jetë sërish produkt origjine i Palës Kontraktuese, në rast se vlera e shtuar në Palën Kontraktuese eksportuese është më e madhe se vlera e materialeve origjinuese nga një Palë tjetër kontraktuese me të cilën është i mundur kumulimi.
- Nëse nuk është kështu, produkti i përfutur konsiderohet si origjinues në Palën Kontraktuese që ka vlerën më të lartë të materialeve origjinuese të përdorura.
- Sistemi i kumulimit diagonal lejon po ashtu që produkti origjinues nga një Palë Kontraktuese që është pjesë e skemës së kumulimit të rieksporthet në një tjetër Palë Kontraktuese që bën pjesë në të njëjtën skemë kumulimi dhe origjina e produkteve ruhet.

Foto 2 – Modeli i kumulimit diagonal – të gjithë partnerët mund të kumulojnë mes njëri-tjetrit



<sup>15</sup> Kumulimi rajonal është formë e kumulimit diagonal. Ai bën të mundur që produktet origjinuese në vende të tjera të grupit rajonal të konsiderohen si materiale që e kanë origjinën në vendin e prodhimit.

<sup>16</sup> Nëse punimi ose përpunimi në palën eksportuese përfshin materiale joorigjinuese të punuar ose përpunuara mjaftueshëm (nëse plotësohet RrSP-ja nga lista e rregullave), por nuk shkon përtej operacioneve minimale, produkti mund të vazhdojë të jetë produkt i origjinës i vendit eksportues, në rast se vlera e shtuar në vendin eksportues (përfshi punimin ose përpunimin e mjaftueshëm të materialeve joorigjinuese) është më e madhe sesa vlera e materialeve origjinuese nga vendi tjetër me të cilin është i mundur kumulimi.



Në këtë model të kumulimit diagonal, të katra Palët Kontraktuese (A, B, C dhe D) zbatojnë rregulla identike origjine brenda MTL-së së lidhur midis tyre. Kështu, materialet origjinuese nga Palët Kontraktuese A dhe B mund të përdoren për të prodhuar një produkt origjinues te Pala C, që do të eksportohet më tej te Pala D.

- Prodhimi në Palën Kontraktuese C duhet të jetë më shumë se punim apo përpunim minimal (nuk është e nevojshme të jetë punim ose përpunim i mjaftueshëm), me qëllim që produkti përfundimtar të përftojë origjinën e Palës Kontraktuese C.
- Kur punimi apo përpunimi i kryer në vendin partner nuk shkon përtej operacioneve minimale, produkti i përftuar konsiderohet si origjinues në atë Palë Kontraktuese (p.sh., Palën C), vetëm kur vlera e shtuar<sup>17</sup> atje është më e madhe sesa vlera e materialeve të përdorura që e kanë origjinën në secilën prej Palëve Kontraktuese të tjera.
- Dispozitat e kumulimit diagonal zakonisht përcaktojnë se, nëse në Palën e eksportit nuk është kryer asnjë punim ose përpunim, materialet thjesht ruajnë origjinën e tyre.
- Në rastet kur materialet përbërëse përdoren nga një Palë Kontraktuese e cila nuk ka MTL me Palën e destinacionit, ato konsiderohen si materiale të vendit të tretë të origjinës.

Për ta përmbledhur:


- ✓ Nëse të gjitha materialet e përdorura janë materiale origjinuese, produkti duhet të jetë origjinues në Palën e zonës së kumulimit, ku i është nënshtruar operacionit të fundit më shumë se “minimal” ose, nëse ka pasur vetëm një prodhim minimal, aty ku është shtuar vlera më e lartë.

Në disa sisteme kumulimi, për shembull, në sistemet pan-euro-mesdhetare të kumulimit, kumulimi mund të përdoret në një numër të kufizuar Palësh Kontraktuese, përpara sesa të gjitha Palët Kontraktuese përkatëse të kenë lidhur një MTL me njëra-tjetrën, ku parashikohet ky kumulim (e ashtuquajtura “gjeometri variable”). Kjo kërkon publikimin e njoftimeve që tregojnë përmbushjen e kërkesave të nevojshme.

Shembull:

Materiale origjinuese në Malin e Zi (ME) u importuan në BE, ku u prodhua produkti përfundimtar.

- Produkti përfundimtar u eksportua në Marok (MA). Edhe pse BE-ja e Maroku kanë MTL dhe kumulimi midis tyre është i mundur, materia-



<sup>17</sup> Përkufizim – “Vlerë e shtuar” konsiderohet të jetë çmimi *ex-works* minus vlerën doganore për secilin material të përfshirë, që e ka origjinën në palët e tjera kontraktuese me të cilat është i zbatueshëm kumulimi ose, nëse vlera doganore nuk dihet apo nuk mund të konstatohet, çmimi i parë i konstatueshëm i paguar për materialet në palën kontraktuese eksportuese.

let malazeze duhet të trajtohen si materiale joorigjinuese prodhimi për Marokun, pasi Mali i Zi dhe Maroku nuk kanë MTL midis tyre.

- Nëse të njëjtat mallra do të eksportohen në Norvegji, materialet e Malit të Zi duhen konsideruar si materiale origjinuese.
- Shih matricën e kumulimit<sup>18-</sup>

*Kujtesë:*


- ✓ Kumulimet dypalëshe dhe diagonale mund të bëhen vetëm me materiale origjinuese.
- ✓ Materialet që janë tashmë origjinuese në një palë të zonës preferenciale dhe që janë futur si të tilla me vërtetimin e trajtimit preferencial nuk është e nevojshme të jenë të përpunuara mjaftueshëm.

#### 4.1.2.1 Shembull i kumulimit diagonal – të gjitha materialet e përdorura janë materiale origjinuese

##### Prodhimi i kapelave në Serbi (RS) / kumulimi diagonal

Kapelat (NK 6505) janë prodhuar në RS. Për prodhimin e kapelave, eksportuesi në RS përdori:

- Pëlhurë tekstile origjinuese në Bosnje-Hercegovinë (BA) (NK 6004) dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura e kanë origjinën në RS.



- Prodhimi i kapelave është më shumë sesa punim ose përpunim i pamjaftueshëm (Neni 6 i Konventës PEM).

Duke qenë se, për prodhimin e kapelave, prodhuesi në RS përdori pëlhurë tekstile me origjinë nga BA-ja (të gjitha materialet e tjera të përdorura janë materiale origjinuese) dhe të gjitha palët e tjera BA/RS/MN mund të kumulojnë së bashku, rregulli i origjinës zbatohet në bazë të kumulimit diagonal dhe eksportuesi mund të përdorë vërtetimin e origjinës së RS-së për eksportim në MN.

Kështu, eksportuesi RS mund të lëshojë certifikatën EUR.1 (origjina nga RS) për eksport në ME, por edhe për të gjitha palët e tjera me të cilat është i mundur kumulimi.

Shih matricën e kumulimit<sup>20</sup>.

<sup>18</sup> “Matrica”, e cila paraqet protokollet/lidhjen me Konventën që gjejnë zbatim midis vendeve të ndryshme partnere, botohet në Fletoren Zyrtare të BE-së dhe në Palë të tjera Kontraktuese dhe përditësohet sistematikisht – shih 2018/C 325/06, datë 14.09.2018.

#### 4.1.2.2 Shembull i kumulimit diagonal – materialet e përdorura origjinuese dhe joorigjinuese

##### Prodhimi i lëngut të portokallit / kumulim diagonal

Kompania malazeze prodhon lëng portokalli (NK 2202). Në procesin e prodhimit eksportuesi ka përdorur një lëng koncentrat frutash nga BE-ja (NK 2009), sheqer nga BE-ja (NK 1701), ujë nga Mali i Zi (NK 2201) dhe acid asorbik kinez (NK 2936). Lëngu i portokallit eksportohet në Kosovë\* (KO).


PSR (NK 2202): Prodhimi:

- nga materialet e çdo kreu, me përjashtim të atij të produktit,
- në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura të Kapitullit 17 nuk e tejkalon 30 % të çmimit ex-works të produktit dhe
- në të cilin i gjithë lëngu i frutave që është përdorur (me përjashtim të ananasit, limonit jeshil ose grejppfrutit) është origjinues

Prodhimi i lëngut është më shumë sesa punim ose përpunim i pamjaftueshëm (Neni 6 i Konventës PEM).

Duke qenë se në prodhimin e lëngut të portokallit përdoren edhe materiale joorigjinuese (Acid asorbik nga Kina), duhet përmbushur RrSP-ja për të përfutuar origjinën nga Mali i Zi.

- Kërkesa e parë është e përmbushur, pasi prodhuesi ka përdorur të gjitha materialet e krerëve, përveç një produkti (CTH – 2009, 1701, 2201, 2936 =>2202).
- Edhe kërkesa e parë dhe e dytë janë përmbushur, pasi prodhuesi përdori sheqer dhe lëng frutash nga BE-ja në prodhim (është siguruar kumulim diagonal midis ME/EU/KO – shih matricën e kumulimit<sup>19</sup>).



\* Ky emërtim nuk paragjykon qëndrimet mbi statusin dhe është në përputhje me Rezolutën 1244/1999 të KSKB dhe Opinionin e GjND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës

Kështu, eksportuesi i Malit të Zi mund të lëshonte EUR.1 (originë nga ME-ja) për eksportin në KO, por edhe për të gjitha palët e tjera me të cilat është i mundur kumulimi.

Nëse për prodhimin e lëngut të portokallit (NK 2202), në vend të lëngut të koncentruar të frutave nga BE-ja prodhuesi do të kishte përdorur lëng të koncentruar frutash joorigjinues (NK 2009), për shkak të kushtit të tretë, rregulli i origjinës nuk mund të përmbushej dhe nuk do të mund të përfitohej origjina nga ME-ja.

#### 4.1.3 Kumulimi i plotë

Kumulimi i plotë ose kumulimi me materiale joorigjinuese është lloji më elastik i kumulimit<sup>19</sup>.

Ndryshe nga kumulimi diagonal, kumulimi i plotë lejon kumulimin e origjinës duke marrë parasysh përpunimin që është shtuar në territorin e MTL-se, edhe kur inputi fillestar nuk është origjinues. Ai krijon mundësinë që materialet joorigjinuese, që nuk kanë sjellë ende si rezultat një produkt origjinues, të merren parasysh si inpute për qëllime kumulimi dhe t'i shtohen procesit të prodhimit, që kryhet në një palë tjetër të zonës së kumulimit të plotë.

*Kjo nënkupton se të gjitha operacionet e kryera në të gjitha fazat e përpunimit apo transformimit të produktit brenda palëve të ndryshme pjesëmarrëse në zonën e kumulimit merren së bashku. Nëse përpunimi i kryer në një palë është vetëm operacion minimal, atëherë kumulimi i plotë nuk mund të zbatohet.*

Për këtë nuk duhet që mallrat ta kenë origjinën nga një prej palëve të zonës përpara sesa të eksportohen për punim apo përpunim të mëtejshëm në një tjetër palë të zonës, por duhet që i gjithë punimi apo përpunimi i parashikuar në listën e rregullave të kryhet në materiale joorigjinuese, me qëllim që produkti përfundimtar të përftojë origjinën preferenciale.

Si rrjedhojë, kjo mundëson ndarjen e punimit ose përpunimit midis Palëve Kontraktuese.

Megjithatë, duhet të jetë e qartë se për këto materiale origjinuese të përdorura nuk do të ofrohet trajtim tarifor preferencial. Trajtimi tarifor preferencial mund të zbatohet vetëm për importet e produkteve që janë tashmë origjinuese. Për të maksimizuar efektin pozitiv të kumulimit të plotë dhe për të mos paguar detyrimet doganore për materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e produktit origjinues, kumulimi i plotë lidhet shumë shpesh me sistemin e tërheqjes nga detyrimet doganore, i cili zbatohet së bashku procedurën e regjimit të përpunimit aktiv<sup>20</sup>.

Dokumenti që vërteton përpunimin e kryer në vendin tjetër partner është deklarata që lëshon furnitori për mallrat që nuk kanë status preferencial origjine.


<sup>19</sup> Palët e CEFTA-s nuk e kanë përdorur deri më tani kumulimin e plotë. Aktualisht, BE-ja përdor kumulimin e plotë me disa partnerë tregtarë, si vendet e ZEE-së, disa shtete të MPE-së, MAGREB-it (Maroku, Algjeria dhe Tunizia), vendet e VTD-të (Vendet dhe Territoret përtej Detit), Kanadanë, Japoninë...

<sup>20</sup> Në përputhje me dispozitat kombëtare. Zakonisht, regjimi i përpunimit aktiv bën të mundur që lënda e parë apo mallrat gjysmë të gatshme të përpunohen për t'u riekportuar, pa kushtin që prodhuesit të jenë të detyruar të paguajnë tarifën doganore të TVSh-në mbi materialet joorigjinuese që janë përdorur.

*Kujtesë:*

- ✓ Mallrat nuk duhet të jenë origjinuese përpara sesa të eksportohen nga një palë në tjetrën për punim ose përpunim të mëtejshëm (si në rastin e kumulimit dypalësh dhe diagonal), por punimi ose përpunimi duhet të jetë më i madh sesa operacionet minimale në Palët Kontraktuese.
- ✓ Kjo e bën më të lehtë plotësimin e kushtit për përfitim të origjinës në palët e ndryshme pjesëmarrëse në kumulimin e plotë.

*Foto 3 – Modeli i kumulimit të plotë*



## 5 Specifikat e kumulimit të plotë në Palët e CEFTA-s

Neni 2 i Vendimit 3/2015 të CEFTA-s përcakton se, për qëllime të zbatimit të Nenit 2(1) (b) të Shtojcës I të Konventës, punimi dhe përpunimi që kryhet në Palët e CEFTA-s konsiderohet si i kryer në secilën prej Palëve të tjera të CEFTA-s, kur produktet e përfuara i nënshtrohen punimit apo përpunimit të mëtejshëm në një prej këtyre Palëve. Mbështetur në këtë dispozite, produktet origjinuese të përfuara në dy ose më shumë Palë përkatëse konsiderohen si origjinuese në CEFTA, vetëm nëse punimi dhe përpunimi shkon përtej operacioneve të përmendura në Nenin 6 të Shtojcës I të Konventës.

Po kështu, Neni 10 i të njëjtit Vendim shprehet se ndalimi i tërheqjes nga detyrimet doganore nuk zbatohet në tregtinë dypalëshe midis Palëve të CEFTA-s<sup>21</sup>.

### 5.1 Zbatimi i kufizuar i përjashtimeve

Neni 1 Vendimit 3/2015 të CEFTA-s parashikon që produktet që përftojnë status origjinues në Palën e CEFTA-s nëpërmjet zbatimit të kumulimit dhe/ose DDB-së përjashtohen nga kumulimi në bazë të dispozitave të përgjithshme e Konventës PEM (Neni 3 i Shtojcës I të Konventës PEM).


Ai siguron që këto “përjashtime” të përfshijnë vetëm me tregtinë preferenciale midis Palëve të CEFTA-s dhe të mos kenë efekt mbi tregtinë me Palët e tjera Kontraktuese të Konventës PEM.

Kjo nënkupton që produktet që përftojnë origjinën përmes zbatimit të kumulimit të plotë/ tërheqjes nga detyrimet doganore midis Palëve të CEFTA-s nuk konsiderohen si mallra origjinuese kur eksportohen Palët të tjera të Konventës PEM. Po kështu, është e pamundur që ato të përdoren si materiale origjinuese për prodhimin e produkteve për eksport në Palët e tjera që nuk janë në CEFTA.

---

<sup>21</sup> Neni 10 përfshin gjithashtu të ashtuquajturën klauzolë mundësuese, d.m.th., mundësia potenciale e tërheqjes apo rimbursimit me vendet e BE-së dhe EFTA-s, në rast se përmbushen të gjitha kushtet e parashikuara në Nenin 10(2).

Foto 4 – Modeli i kumulimit të plotë – efekti mbi tregtinë me Palët e tjera Kontraktuese të Konventës PEM



Në situatën kur materialet origjinuese, që i janë nënshtruar më shumë sesa përpunimit minimal në një prej Palëve të CEFTA-s, por nuk kanë përfunduar origjinën, eksportohen në një Palë tjetër të CEFTA-s, eksportues në Palën e parë të CEFTA-s mund të lëshojë një deklaratë furnitori që vërteton llojin e përpunimit që është kryer mbi materialet joorigjinuese. Ky material joorigjinues mund të përdoret më pas në Palë të tjera të CEFTA-s në prodhimin e produktit përfundimtar dhe duhen marrë së bashku, kur vendoset nëse produkti përfiton ose jo statusin origjinues (duhet zbatuar RrSP).

Nëse prodhimi është më i madh sesa i pamjaftueshëm dhe plotësohet RrSP-ja, për këtë produkt mund të lëshohet vërtetimi i origjinës kur eksportohet në Palë të tjera të CEFTA-s.

Duke qenë se, sipas Vendimit 3/2015 të CEFTA-s, rregulli i ndalimit të tërheqjes nga detyrimet doganore nuk gjen zbatim midis Palëve të CEFTA-s, po kështu nuk është e nevojshme që, përpara lëshimit të vërtetimit të origjinës, të përlogariten tarifatat doganore mbi materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim.

Megjithatë, nëse një produkt i tillë do të eksportohet në Palë të tjera Kontraktuese të Konventës PEM, pavarësisht faktit që Pala e CEFTA-s duhet të ketë një MTL me këtë Palë Kontraktuese, ai nuk mund të eksportohet me vërtetim origjine dhe Pala tjetër Kontraktuese e konsideron këtë mall si mall joorigjinues.

Kujtesë:

- ✓ Nëse produkti ka përfuar origjinën nëpërmjet përdorimit të kumulimit të plotë/ tërheqjes nga detyrimet doganore, mbështetur në Vendimin 3/2015 të CEFTA-s, kjo vlen vetëm për tregtinë preferenciale midis Palëve të CEFTA-s dhe nuk ka asnjë efekt mbi tregtinë me Palë të tjera Kontraktuese të Konventës PEM.
- ✓ Mallrat që përftojnë statusin origjinues duke shfrytëzuar këtë mundësi nuk trajtohen si mallra origjinuese kur importohen në Palë të tjera Kontraktuese të Konventës PEM.

### 5.1.1 Ç'vërtetim origjine duhet lëshuar?

Neni 3 i Vendimit 3/2015 të CEFTA-s parashikon se, nëse produktet përfundimtare mund të konsiderohen produkte që origjinojnë në një Palë të CEFTA-s, mbështetur në kumulimin e plotë dhe plotësimin e kërkesave të tjera të Shtojcës I, atëherë lëshohet EUR.1 ose një deklaratë origjine që mund të hartohet nga eksportuesi i produktit përfundimtar në Palën e CEFTA-s.

Për gjurmueshmërinë e mallrave që përftojnë origjinën në bazë të kumulimit të plotë/ DDB-së është e nevojshme të përdoret një tregues për të identifikuar situatën kur lëshohet EUR.1 ose kur hartohet deklarata e origjinës, mbështetur në Vendimin e CEFTA-s. Kështu, për të dalluar produktet origjinuese sipas Konventës PEM nga produktet origjinuese që janë të tilla falë mundësisë së përjashtimit të parashikuar në Vendimin 3/2015 të CEFTA-s, Palët e CEFTA-s përfshinë treguesin e mëposhtëm në deklaratën e origjinës dhe në EUR.1 (Kutia 4 dhe Kutia 7: Komente).

➤ Në deklaratën e origjinës:

“Sipas Vendimit 3/2015 të CEFTA-s, në fund të Deklaratës së Origjinës, si fjali e re përfundimtare”

➤ Në EUR.1 - Kutia 4:

CEFTA / Palë e CEFTA-s (p.sh. CEFTA/Maqedonia e Veriut)

➤ Në EUR.1 - Kutia 7:

“Sipas Vendimit 3/2015 të CEFTA-s”.




## 5.2 Deklarata e furnitorit (DF)

Deklarata e furnitorit është një deklaratë e hartuar nga furnitori, përmes së cilës i ofron informacion klientit të tij rreth statusit origjinues të mallrave. Furnitori është personi që ka kontroll dhe njohuri mbi statusin origjinues të mallrave – pavarësisht faturimit.

*Shembull:*

*Kompania A i shet mallra kompanisë C, e cila ia rishet ato kompanisë B. Me porosi të kompanisë C, kompania A ia dërgon mallrat drejtpërdrejt kompanisë B.*



*Kompania A i ka të gjitha informacionet lidhur me statusin e origjinës së mallrave dhe mund t'i lëshojë drejtpërdrejt një DF kompanisë B, pavarësisht lëshimit të faturës. Në një situatë të tillë, kompania A duhet të lëshojë DF-në bashkëlidhur notës dërguese, listës së ambalazhit ose çdo dokumenti tjetër tregtar që përshkruan mallrat me hollësi të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin e tyre.*

*Përgjithësisht, deklarata e furnitorit mund të lëshohet:*

Përgjithësisht, deklarata e furnitorit mund të lëshohet:

- ✓ për mallrat që përftojnë origjinë preferenciale (vetëm për mallrat origjinuese që tregtohen brenda Palës Kontraktuese) dhe
- ✓ për mallrat joorigjinuese (të përdorura kur zbatohet kumulimi i plotë).

Furnitori mund të lëshojë:

- ✓ një deklaratë furnitori më vete për çdo dërgesë ose
- ✓ të ashtuquajturën deklaratë afatgjatë të furnitorit.


Ndryshe nga deklarata e furnitorit për mallrat origjinuese, deklarata e furnitorit për mallrat joorigjinuese nuk i vërteton marrësit të dërgesës statusin origjinues ekzistues të mallrave.

Më shumë, ajo përmban një deklaratë rreth materialeve joorigjinuese dhe origjinuese që përdoren përgjithësisht në prodhim. Ajo shërben si vërtetim i punimit ose përpunimi të kryer mbi materialet në fjalë në Palët e CEFTA-s. Në këtë mënyrë, përcaktohet nëse produktet (e prodhuara nga materialet në fjalë) mund të konsiderohen si produkte origjinuese në Palët e CEFTA-s, pas plotësimit të kushteve të përcaktuara.

Kjo deklaratë trajtohet si dokument mbështetës për lëshimin e EUR.1 ose vërtetimit të origjinës, nëse mallrat për eksport përftojnë statusin origjinues duke përdorur këtë DF dhe në përmbushje të gjitha kushteve të tjera të përcaktuara.

Është e qartë se deklarata e furnitorit mund të mbështetë edhe hartimin e një deklarate vijuese të furnitorit kur mallrat rishiten, dërgohen ose transferohen midis furnitorëve.

Po kështu, ajo mund të përdoret edhe nëse materialet joorigjinuese ndryshohen në një prej palëve (pa përfshirë origjinën - ndjekur nga deklarata e furnitorit) dhe ndryshohen më tej në një palë tjetër, duke marrë parasysh të gjitha materialet e përdorura.



Duhet theksuar se furnitori nuk ka detyrim ligjor të hartojë deklaratën e furnitorit dhe asnjë autorizim nuk kërkohet për lëshimin e deklaratës së furnitorit. Megjithatë, furnitori duhet ta formulojë këtë deklaratë për shkak të detyrimeve tregtare.

### 5.2.1 Deklarata e furnitorit (për një ngarkesë)

Furnitori mund të lëshojë një deklaratë furnitori për çdo ngarkesë malli ose një DF afatgjatë që do të mbulojë dërgesat e njëpasnjëshme të mallrave identike.

Deklarata e veçantë e furnitorit:

- ✓ Bëhet nga furnitori për çdo dërgesë mallrash në formatin e përcaktuar<sup>22</sup>.
- ✓ Formulari i të gjitha deklaratave të furnitorit është i detyrueshëm. Teksti i deklaratës së furnitorit duhet të bëhet në përputhje me shënimet shpjeguese, po nuk ka nevojë që këto shënime të riprodhohen.
- ✓ Bëhet në një letër që i bashkëlidhet faturës, notës së dorëzimit apo çdo dokumenti tjetër tregtar që përshkruan mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin e tyre.
- ✓ Shtypet me germa shtypi ose printohet nga furnitori në gjuhën angleze dhe mban nënshkrimin e furnitorit me shkrim dore. Po kështu, deklarata mund të shkruhet me shkrim dore; në këtë rast, ajo shkruhet me bojë me shkronja shtypi.

### 5.2.2 Deklarata afatgjatë e furnitorit

Deklarata afatgjatë e furnitorit mbulon dorëzimet e ngarkesave të njëpasnjëshme me të cilat furnitori furnizon rregullisht klientin e mallrave, për të cilin punimi ose përpunimi që është kryer në Palët e CEFTA-s pritet të mbetet konstant për një periudhë të konsiderueshme.

<sup>22</sup> Formati i deklaratës së furnitorit – format tip - Shtojca 1 e Vendimit 3/2015 të CEFTA-s dhe Aneksi 3 i këtij dokumenti.

Ajo i krijon lehtësi furnitorit që dërgon produkte identike, pasi, brenda një kohe të dhënë, është e nevojshme vetëm një deklaratë furnitori për të mbuluar të gjitha produktet, në vend të deklaratave të veçanta për çdo dërgesë individuale.

Deklarata afatgjatë e furnitorit:

- ✓ Hartohet nga furnitori në formatin e përcaktuar<sup>23</sup> në një fletë letre që i bashkëlidhet faturës, notës së dorëzimit ose një dokumenti tjetër tregtar, duke përshkruar mallrat përkatëse me hollësi të mjaftueshme për të bërë të mundur identifikimin e tyre. Formulimi i të gjitha deklaratave të furnitorit është i detyrueshëm. Teksti i deklaratës së furnitorit duhet hartuar në përputhje me shënimet fundore, por këto shënime fundore nuk duhet të riprodhohen.
- ✓ Shkruhet me germa shtypi ose printohet nga furnitori në gjuhën angleze dhe mban nënshkrimin origjinal të furnitorit me shkrim dore. Po kështu, deklarata mund të shkruhet me shkrim dore. Në këtë rast, ajo shkruhet me bojë dhe me shkronja shtypi.
- ✓ Është e vlefshme për të gjitha dërgesat vijuese të mallrave identike<sup>24</sup> në fjalë, të dorëzuara përgjatë një periudhe deri në një vit<sup>25</sup> nga data e lëshimit të DF-së afatgjatë. Të gjitha të dhënat nga deklarata afatgjatë e furnitorit duhet të jenë të njëjta përgjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së deklaratës.
- ✓ Furnitori njofton menjëherë klientin e mallrave, në rast se të dhënat në deklaratën e tij afatgjatë të furnitorit nuk janë më të vlefshme.
- ✓ I jepet klientit përkatës, përpara sesa i të furnizohet ose me dërgesën e parë të mallrave që mbulohe nga kjo deklaratë.

Deklarata afatgjatë e furnitorit duhet të përmbajë tri data:

- Datën e bërjes së deklaratës së furnitorit (data e lëshimit).
- Datën nga e cila nis vlefshmëria e deklaratës së furnitorit (data e fillimit) dhe
- Datën kur përfundon periudha e vlefshmërisë (data e përfundimit), e cila nuk mund të jetë më vonë sesa 12 muaj pas datës së lëshimit.


---

<sup>23</sup>Formati i deklaratës afatgjatë të furnitorit – format tip - Shtojca 2 e Vendimit 3/2015 të CEFTA-s dhe Aneksi 3 i këtij dokumenti.

<sup>24</sup>Produkte identike janë produktet që përkojnë në çdo aspekt me ato që detajohen në përshkrimin e produktit. Përshkrimi i produktit në dokumentin tregtar të përdorur për hartimin e një DF-je për dërgesa të shumëfishta duhet të jetë, për rrjedhojë, i saktë mjaftueshëm për të identifikuar qartë produktin, por edhe produktet identike që do të importohen në vijim në bazë të kësaj DF-je.

<sup>25</sup>Teksti i Nenit 4 të Vendimit 3/2015 të CEFTA-s i jep mundësi autoritetit doganor të një Pale të CEFTA-s ku është bërë deklarata të përcaktojë kushtet në bazë të të cilave mund të zbatohen afate më të gjata

- ✓ Data e lëshimit të DF-së afatgjatë nuk vjen pas datës së fillimit, por mund të jetë përpara saj.




- ✓ Afati maksimal 12-mujor i vlefshmërisë së DF-së afatgjatë nuk nënkupton se furnitori është i detyruar ta lëshojë DF-në për një periudhë prej 12 muajsh. I takon atij të vendosë. Afati i vlefshmërisë në të cilin furnitori mund të vërtetojë se të gjitha të dhënat nga DF-ja afatgjatë janë të njëjta dhe të sakta mund të jetë më i shkurtër.

### 5.2.3 Plotësimi i deklaratës së furnitorit

DF-ja (dhe DF-ja afatgjatë) përmban të gjitha të dhënat për mallrat e ofruara. Ajo përbëhet nga tri pjesë dhe përfshin të dhënat në vijim:

- të dhëna për mallrat që ofron furnitori, të cilat i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Palët e CEFTA-s, pa përfutuar statusin e origjinës preferenciale dhe të dhëna mbi materialet e përdorura për to;
- të dhëna mbi faktin se të gjitha materialet e përdorura në Palët e CEFTA-s për prodhimin e mallrave përfundimtare e kanë origjinën nga Palët e CEFTA-s, (BE, Ishujt Faroe, Islanda, Norvegjia, Zvicra (përfshi Lihtenshtajnin) ose Turqia)<sup>26</sup>;
- të dhëna për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë palëve të CEFTA-s dhe vlerën totale të shtuar jashtë Palëve të CEFTA-s, në përputhje me Nenin 11 (Parimi i territorialitetit) të Shtojcës I të Konventës PEM.



<sup>26</sup>Mundësi potenciale

Të dhëna mbi mallrat e furnizuara nga furnitori:

Përshkrimi i mallrave të furnizuara	Përshkrimi i materialeve joorigjinuese të përdorura	Kodi tarifor i materialeve joorigjinuese të përdorura	Vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura
Vlera gjithsej			

Tabela e parë në formatin e DF-së dhe në formatin e DF-së afatgjatë përmban të dhëna rreth mallrave të furnizuara nga furnitori, që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Palët e CEFTA-s, pa përfutur statusin e origjinës preferenciale. Po kështu, ajo përmban të gjitha të dhënat rreth materialeve të përdorura për prodhimin e tyre.

Kolona I – Përshkrimi i mallrave të furnizuara

Ky informacion duhet të jetë i hollësishëm mjaftueshëm, për të identifikuar qartë mallrat që furnizon furnitori.

Kur fatura, nota e dërgesës apo dokumente të tjera tregtare të cilave u bashkëlidhet deklarata kanë të bëjnë me lloje të ndryshme mallrash ose me mallra që nuk përbëhen nga materiale joorigjinuese në të njëjtën masë, furnitori duhet të bëjë një dallim të qartë midis tyre.

Shembull:

- DF-ja është për transformatorët (Kreu 8504) që janë prodhuar në një prej Palëve të CEFTA-s, për t'u përdorur në një Palë tjetër të CEFTA-s për prodhimin e kondicionerëve të ajrit (NK 8415).
- Natyra dhe vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura për prodhimin e këtyre transformatorëve ndryshojnë nga njëri model në tjetrin.

Përshkrimi i mallrave të furnizuar	Përshkrimi i materialeve joorigjinuese të përdorura	Kreu i materialeve joorigjinuese të përdorura	Vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura
<b>Transformator 1</b> <b>75 VA 230/24 V</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tela të mbështjella bakri</li> <li>• Kabull prej hekuri</li> </ul>		3 EUR
			4 EUR
		<b>Vlera gjithsej</b>	7 EUR
<b>Transformator 2</b> <b>60 VA 230/12 V</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Tela të mbështjella bakri</li> <li>• Kabull prej hekuri</li> </ul>		2 EUR
			4 EUR
		<b>Vlera gjithsej</b>	6 EUR

- ✓ Për modelin 1, janë përdorur tela të mbështjellë bakri (NK 8544) me vlerë 3 euro dhe kabull hekuri (NK 8504) me vlerë 4 euro.
- ✓ Për modelin 2, janë përdorur tela të mbështjellë bakri (NK 8544) me vlerë 2 euro dhe kabull hekuri (NK 8504) me vlerë 4 euro.
- Për rrjedhojë, modelet duhen dalluar në kolonën e parë dhe të dhënat në kolonat e tjera duhen paraqitur më vete për secilin model, me qëllim që prodhuesi i kondicionerëve të ajrit të ketë mundësi të bëjë vlerësimin e saktë të statusit origjinues të produkteve të tij, në varësi të secilit prej transformatorëve që përdor.

#### Kolona II – Përshkrimi i materialeve joorigjinuese të përdorura

Kolona e dytë përmban të dhëna lidhur me materialet joorigjinuese të përdorura në prodhimin e mallrave të furnizuara.

#### Kolona III – Kreu i materialeve joorigjinuese të përdorura

Kolona e tretë përmban të dhëna mbi kreun tarifor të materialeve joorigjinuese që janë përdorur për prodhimin e mallrave të furnizuara. Të dhënat që kërkohen në këto kolona duhet të jepen vetëm nëse janë të nevojshme.

- ✓ *Në shembullin e mësipërm të kondicionerëve të ajrit (NK 8415) për të cilët janë përdorur transformatorët (NK 8504), RrSP-ja përcakton se mund të përdoren maksimumi 40 për qind materiale joorigjinuese. Për shkak të llojit të RrSP-së, kreu tarifor për telat e mbështjella prej bakri (NK 8544) dhe kabullin e hekurit (NK 8504) nuk janë me rëndësi, ndaj nuk është nevoja që kjo kolonë të plotësohet. Megjithatë, vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura është shumë e rëndësishme, pasi eksportuesi fundor do t'i marrë parasysht në përfitim të origjinës.*
- ✓ *Ose, rregulli për veshjet i ex-kapitullit 62 parashikon se mund të përdoret filli joorigjinues. Nëse prodhuesi i këtyre veshjeve në Serbi përdor pëlhurë të importuar nga Mali i Zi, që është përftuar atje nëpërmjet thurjes me fill joorigjinues, mjafton që furnitori malazez të përshkruajë në deklaratën e tij materialet joorigjinuese të përdorura si fill, pa qenë e nevojshme të shënojë kreun dhe vlerën e këtij filli. Kjo bëhet, pasi ato nuk janë të rëndësishme në marrjen e vendimit për përfitim të origjinës të mallrave përfundimtare. Rëndësi ka vetëm që prodhimi ka nisur nga filli, pavarësisht kreut tarifor dhe vlerës së materialeve të përdorura.*

#### Kolona IV – Vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura

Kolona e katërt përmban të dhëna rreth vlerës së materialeve joorigjinuese të përdorura në prodhimin e mallrave të furnizuara. “Vlera e materialeve” është vlera doganore e materialeve të përdorura në kohën e importit të materialeve joorigjinuese të përdorura ose, nëse kjo nuk dihet dhe nuk mund të vërtetohet, çmimi i parë i verifikueshëm i paguar për materialet në një prej Palëve të CEFTA-s. Vlera e saktë për secilin material joorigjinues të përdorur duhet paraqitur për njësi malli, sipas specifikimit në kolonën e parë.

Po kështu, deklarata e furnitorit duhet të përmbajë të dhëna rreth mallrave që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit jashtë Palëve të CEFTA-s, në përputhje me Parimin e territorialitetit<sup>27</sup>.

- Në rubrikën, “*Vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Palëve të CEFTA-s*”, me “*Vlera totale e shtuar*” kuptohen të gjitha kostot e akumuluaras jashtë Palëve të CEFTA-s, përfshi vlerën e të gjitha materialeve të shtuara atje. Vlera e saktë totale e shtuar, që është përftuar jashtë Palëve të CEFTA-s, duhet paraqitur për njësi malli, të specifikuar në kolonën e parë.

Deklarata afatgjatë e furnitorit përmban po kështu të dhëna rreth afatit të vlefshmërisë për të gjitha ngarkesat vijuese të mallrave që do të dërgohen në një periudhë nga ..... deri në..... Afati i vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit nuk duhet t’i kalojë normalisht 12 muajt, sipas kushteve të parashikuara nga autoritetet doganore të vendit ku bëhet deklarata afatgjatë e furnitorit.

#### 5.2.4 Ruajtja e deklaratave të furnitorit dhe dokumenteve mbështetëse

Furnitori që harton DF-në duhet të jetë i përgatitur të paraqesë në çdo kohë, kur kërkohet nga autoriteti doganor i Palës së CEFTA-s në të cilën është bërë deklarata, të gjitha dokumentet përkatëse që vërtetojnë se informacioni i dhënë në atë deklaratë është i saktë.

Furnitori që harton DF-në mban për të paktën tre vjet kopje të deklaratës dhe të gjitha faturave, notave të dërgesës apo çdo dokument tjetër tregtar të cilit i bashkëlidhet kjo deklaratë, si dhe dokumentet përkatëse të cilat vërtetojnë se informacioni i dhënë në DF është i saktë. Në rastin e DF-së afatgjatë, periudha nis nga data e përfundimit të vlefshmërisë së deklaratës afatgjatë të furnitorit.

#### 5.2.5 Bashkëpunimi administrativ dhe verifikimi i deklaratave të furnitorit

Për të siguruar zbatimin e duhur të kumulimit të plotë, autoritetet e Palëve të CEFTA-s ndihmojnë njëra-tjetrën për të kontrolluar origjinalitetin e certifikatave të qarkullimit të mallrave, EUR.1, deklaratat e origjinës apo deklaratat e furnitorit dhe saktësinë e informacionit të paraqitur në këto dokumente.

Procedura e verifikimit të mëpasëm të origjinalitetit të deklaratës së furnitorit ose vërtetimeve të origjinës, ose saktësisë së informacionit të paraqitur në to, është, në thelb, e njëjta dhe mbështetet nga administratat doganore.

Verifikimet e mëtejshme të deklaratave të furnitorit ose deklaratave afatgjata të furnitorit, si dhe verifikimet vijuese të vërtetimeve të lëshuara të origjinës, mund të kryhen **në mënyrë rastësore** ose kurdo që autoriteti doganor i Palës së CEFTA-s ka **dyshime të arsyeshme** lidhur me origjinalitetin e dokumentit apo saktësinë e informacionit të paraqitur në të.

Nëse ka dyshim për origjinalitetin e dokumentit apo saktësinë e informacioneve të dhëna në deklaratën e furnitorit, procedura e verifikimit është si vijon:

---

<sup>27</sup> Vlera totale e shtuar e përftuar jashtë Palës Kontraktuese nuk duhet të kalojë 10 % çmimit ex work të produktit, për të cilin do të kërkohet statusi origjinues (Neni 11 i Konventës PEM).

- Autoriteti doganor i Palës së CEFTA-s ku janë përdorur këto deklarata furnitori për përfitim e origjinës për mallrat e eksportuara ia kthen deklaratën e furnitorit (ose deklaratën afatgjatë të furnitorit) dhe faturat, notat e dërgimit ose dokumentet e tjera tregtare lidhur me mallrat që mbulon kjo deklaratë autoritetit doganor të Palës së CEFTA-s ku është bërë deklarata.
- Shërbimi doganor duhet të japë, kur është e nevojshme, arsyet e verifikimit.
- Po kështu, ai i dërgon, në mbështetje të kërkesës për verifikim të mëtejshëm, dokumentet dhe informacionet që janë marrë, që tregojnë se informacioni i paraqitur në DF është i pasaktë.

Verifikimi kryhet nga autoriteti doganor i Palës së CEFTA-s ku është bërë deklarata e furnitorit (ose deklarata afatgjatë e furnitorit). Për këtë qëllim, ata kanë të drejtë të kërkojnë prova dhe të kryejnë inspektive të llogarisë së furnitorit ose çdo kontroll tjetër që e konsiderojnë të arsyeshëm.


Autoriteti doganor që kërkon verifikimin informohet për rezultatet sa më shpejt të jetë e mundur (duke marrë në konsideratë afatet kohore për verifikimin e vërtetimit të origjinës që është lëshuar, mbështetur në deklaratën e furnitorit).

Këto rezultate tregojnë qartë nëse informacioni i dhënë në deklaratën e furnitorit është i saktë dhe u japin mundësi autoriteteve të përcaktojnë nëse dhe në ç'shikullë duhet konsideruar kjo deklaratë për lëshimin e certifikatës së qarkullimit të mallrave EUR.1 apo për bërjen e deklaratës së origjinës.

#### SHEMBULL: Procesi i verifikimit të DF-së

- ✓ Shoqëria B i ka lëshuar shoqërisë C një vërtetim origjine. Produkti për eksportim përftoi origjinën preferenciale nëpërmjet kumulimit të plotë mbi përdorimin e materialeve joorigjinuese të blera nga Shoqëria A. Shoqëria A bëri një deklaratë furnitori, ku paraqiten të gjitha materialet joorigjinuese dhe origjinuese të përdorura në prodhim. Shoqëria C zbatoi tarifa doganore preferenciale mbi importin për Palën C.

Foto 5 – Procesi i verifikimit





- ✓ Gjatë kontrollit pas zhdoganimit, autoriteti doganor i Palës C kishte dyshime të arsyeshme për besueshmërinë e vërtetimit të origjinës dhe nisi, përmes bashkëpunimit administrativ, verifikimin e vërtetimit të lëshuar të origjinës.
- ✓ Administrata doganore e Palës B kreu një verifikim më pas në Shoqërinë B, e cila kishte lëshuar vërtetimin e origjinës. Gjatë kontrollit, u pa se kumulimi i plotë ishte zbatuar sipas DF-së dhe se kishte dyshime të arsyeshme për besueshmërinë e DF-së. Përmes bashkëpunimit administrativ, u krye një kontroll te Pala A, në të cilën Shoqëria A kishte lëshuar DF-në. U vërtetua se DF-ja ishte bërë në mënyrën e duhur dhe se ishte e besueshme dhe e justifikuar. Mbështetur te këto të dhëna, dogana e palës B iu përgjigj kërkesës për verifikim të doganës në palën C.
- ✓ Në shembullin e mësipërm, verifikimi u nis nga administrata doganore e palës ku ishte zbatuar tarifa preferenciale doganore. Megjithatë, duhet theksuar se verifikimi i DF-së mund të nisët edhe nga administrata doganore e palës ku është lëshuar vërtetimi i origjinës (bazuar mbi DF-në), qoftë në momentin e lëshimit apo në kontrollet e mëpasme. Po kështu, ky verifikim mund të nisët gjatë çdo lloj kontrolli – për shembull, gjatë kontrollit të rregullt të miratuar të eksportuesit.

### 5.2.6 Pasojat e deklaratës së pasaktë të furnitorit

Për shkak se deklarata e pasaktë e furnitorit mund të çojë në përfundim të lëshimit i një vërtetimi të pasaktë origjine, kjo mund të nënkuptojë se importuesit i duhet të paguajë (kthejë) tarifën për një ose shumë ngarkesa, duke qenë se nuk ekziston vërtetimi i vlefshëm i origjinës, që duhet për të përftuar normat preferenciale tarifore.

Duhet të jetë e qartë se deklarata e furnitorit mund të shërbejë si bazë për deklaratat vijuese të furnitorit, kur mallrat shiten, dërgohen apo transferohen midis furnitorëve.

Po kështu, lëshimi i një deklarate të rreme të furnitorit sjell, për pasojë, një zinxhir të tërë dokumentesh të rreme që janë lëshuar. Deklarata e gabuar jo vetëm çon në humbjen e një klienti apo në kërkesën për të paguar detyrimet doganore, por mund të sjellë edhe pasoja të tjera, p.sh., tatimore ose penale.

Duhet theksuar se autoritetet doganore nuk përfshihen në hartimin e deklaratës së furnitorit. Furnitori është përgjegjës për saktësinë e deklaratës së hartuar për marrësin. Kur bëhet deklarata e furnitorit, është e detyrueshme të plotësohen kërkesat formale. Po ashtu, furnitori është përgjegjës për ta informuar klientin e mallrave menjëherë në rast ndryshimi të rrethanave, si rrjedhojë e të cilave deklarata afatgjatë e furnitorit nuk është më e vlefshme.

Për rastet kur përcaktohet se furnitori ka lëshuar një deklaratë të pasaktë të furnitorit, secila Palë e CEFTA-s mund të parashikojë procedurën e shkeljes në dispozitat kombëtare: (Neni 9: *Çdo person i cili harton ose nxit hartimin e një dokumenti që përmban të dhëna të pasakta, me qëllim përftimin e trajtimit preferencial të produkteve, është subjekt i sanksioneve*).

Po kështu, nëse deklarata e pasaktë e furnitorit leshtohet nga eksportuesi i miratuar, një prej masave që mund të merren është edhe vendimi për sekuestrimin e ngarkesës së eksportuesit të miratuar.

### 5.3 Shembull i kumulimit të plotë – rregulli i vlerës së shtuar

Një shoqëri shqiptare prodhon çadra (NK 6601) dhe i shet ato në Bosnje-Hercegovinë me çmim *ex-work* prej 4 eurosh. Procesi i prodhimit:

#### SHOQËRI SHQIPTARE PËR PRODHIMIN E ÇADRAVE (NK 6601)

Materiali i përdorur për fabrikimin e çadrave:

- MATERIALE TEKSTILE TË QEPURA – pjesë çadre (NK 6307) – të blera nga një shoqëri serbe me çmim 1 euro EXW (materiale joorigjinuese) – norma tarifore KMF mbi importin në Shqipëri është 0%;
  - PJESË ÇADRE PREJ ALUMINI – skelete dhe tela (NK 6603) – të blera nga një shoqëri kineze me çmim 1,3 euro EXW (materiale joorigjinuese) – norma tarifore mbi importin në Shqipëri është 15%;
  - PJESET PLASTRIKE (NK 6603) janë blerë nga prodhuesi shqiptar me çmim 0,3 euro EXW – shoqëruar me deklaratën e furnitorit për mallrat origjinuese;
  - Prodhimi më shumë se minimal.
- Lista e rregullave për NK 6601 përcakton se **vlera totale të gjitha materialeve joorigjinuese nuk duhet të jetë më shumë se 50% e çmimit përfundimtar EXW.**

#### SHOQËRIA SERBE E PRODHIMIT TË MATERIALEVE TEKSTILE TË QEPURA (NK 6307)

Materiali i përdorur në prodhim:

- MATERIAL TEKSTIL (NK 5512) i importuar nga Bangladeshi, me çmim 0,5 euro EXW (materiale joorigjinuese) – tarifa e importit mbi materialin tekstil është 10%;
  - MATERIALET E TJERA të përdorura janë me origjinë serbe;
  - Prodhim më shumë se minimal.
- Lista e rregullave për NK 6307 përcakton **prodhim në të cilin vlera e të gjitha materialeve të përdorura nuk është më e madhe sesa 40 % e çmimit EXW të produktit.**

#### **PËRFTIMI I ORIGJINËS PREFERENCIALE TË ÇADRËS SË PRODHUAR NË SHQIPËRI**

Në vijim paraqitet një krahasim i rasteve kur zbatohet Konventa Rajonale PEM (pa zbatuar përjashtimet e CEFTA-s – kumulimin e plotë dhe tërheqjen nga detyrimet doganore) dhe situatës kur zbatohet Vendimi 3/2015 i CEFTA-s, me mundësinë e kumulimit të plotë dhe DDB-së. I gjithë qëllimi është të tregojmë dallimin dhe mundësitë që kjo alternativë e re lejon.

- PA KUMULIM TË PLOTË DHE TËRHEQJE NGA DETYRIMI DOGANOR – Konventa PEM aktualisht në zbatim


Në prodhimin e çadrës, fabrikuesi ka përdorur tekstil të qepur joorigjinues dhe pjesë alumini.

Vlera e materialeve joorigjinuese të përdorura në prodhimin e çadrave është 2,3 euro EXW (material tekstil i qepur + pjesë alumini), që përkohet me 57,5 % të çmimit të përgjithshëm të çadrës (4 euro EXW).

RrSP-ja për NK 6601 përcakton se çadra e përfiton origjinën e vendit eksportues, nëse është në përputhje me listën e rregullave (*vlera totale e të gjitha materialeve joorigjinuese nuk duhet të jetë më e madhe sesa 50% e çmimit përfundimtar*).

Kur çadrat eksportohen në Bosnje-Hercegovinë, nuk është e mundur të lëshohet vërtetimi i origjinës, pasi në prodhimin e tyre janë përdorur 57.5 % materiale joorigjinuese. Kjo sjell si rezultat përlogaritjen e detyrimit doganor prej 15% për hedhjen në qarkullim të lirë të çadrave në Bosnje-Hercegovinë.

Foto 6. Përftimi i origjinës preferenciale – pa KP dhe DDB




- RASTI KUR ZBATOHET KUMULIMI I PLOTË DHE TËRHEQJA NGA DETYRIMI DOGANOR (Vendimi 3/2015 i CEFTA-s)

Në prodhimin e materialit tekstil të qepur (NK 6307), shoqëria serbe përdori materiale tekstile joorigjinuese të blera nga një prodhues nga Bangladeshi (NK 5512) me çmim 0,5 euro EXW. Të gjitha materialet e tjera kanë origjinë preferenciale serbe.

Prodhimi është më shumë sesa prodhim minimal, por materiali tekstil i qepur është ende joorigjinues, duke qenë se nuk plotësohet RrSP për NK 6307.

Pavarësisht kësaj, prodhuesi serb mundi t'i lëshojë deklaratën e furnitorit shoqërisë shqiptare, ku konfirmohej se në prodhimin e materialit tekstil të qepur (NK 6307) ishin përdorur materiale joorigjinuese me vlerë 0,5 euro EXW dhe të gjitha materialet e tjera të përdorura ishin materiale origjinuese.

Foto 7- Përftimi i origjinës preferenciale – me zbatimin e KP-së dhe DDB-së



Më pas, shoqëria shqiptare, në përlllogaritjen e materialeve joorigjinuese të përdorura për prodhimin e produktit përfundimtar (çadra, NK 6601), e llogarit si material joorigjinues këtë 0,5 euro dhe pjesët joorigjinuese të aluminit prej 1,3 euro, për një total prej 1,8 euro EXW. Kjo përkon me 45 % të çmimit EXW të çadrës.


Ne mund të dalim në përfundimin se, për prodhimin e produktit final, përdoret 45 % e materialeve joorigjinuese, që na çon në konkluzionin se RrSP-ja në listën e rregullave është plotësuar dhe shoqëria shqiptare mund të lëshojë një vërtetim origjine, kur i eksporton çadrat në Bosnje-Hercegovinë<sup>28</sup>. Kjo nënkupton se në Bosnje-Hercegovinë do të zbatohet tarifa doganore prej 0%.

Po kështu, duhet marrë në konsideratë fakti se, për shkak të përdorimit të regjimit të përpunimit të aktiv dhe zbatimit të rregullit të tërheqjes nga detyrimi doganor<sup>29</sup>, nuk është e nevojshme që norma tarifore të përlllogaritet për të gjitha materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim, përpara sesa të lëshohet vërtetimi i origjinës (ose detyrimi doganor mbi importin i paguar për materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim mund të rimbursohet).

<sup>28</sup> Ose Palë të tjera të CEFTA-s

<sup>29</sup> Shih rubrikën 6 – Tërheqja nga detyrimi doganor

Foto 7.1 – Përftimi i origjinës preferenciale – me zbatimin e KP-së dhe DDB-së



#### Përfundim:

Si konkluzion, në një situatë ku nuk është i mundur zbatimi i kumulimit të plotës/tërheqjes nga detyrimi doganor mbi importin e çadrave nga Shqipëria në Bosnje-Hercegovinë, duhet të aplikohet tarifa doganore prej 15%. Nëse ekziston mundësia për të zbatuar kumulimin e plotë/tërheqjen nga detyrimi doganor, ajo u jep mundësinë kompanive të përdorin materiale joorigjinuese që ende nuk kanë sjellë si rezultat një produkt origjinues. Më pas, ato mund të konsiderohen si njësi hyrëse për qëllime kumulimi dhe t'i shtohen procesit të prodhimit që kryhet nga shoqëria tregtare në një tjetër palë të zonës së kumulimit të plotë. Atëherë, të dyja merren në konsideratë së bashku si produkt origjinues, nëse përmbushen rregullat e tjera e nëse mallrat përftojnë origjinën.

Kështu, në këtë rast, i njëjti arsyetim na jep mundësinë të përdorim materiale joorigjinuese nga Bangladeshi, që janë më të lira sesa materialet origjinuese nga zona e MTL-së. Kjo, në fund, mundëson një prodhim më të lirë të produktit të përfunduar dhe hedhjen e tij në qarkullim pa aplikuar asnjë detyrim doganor në zonë e zbatimit të kumulimit të plotë.

Kumulimi i plotë/DDB-ja midis Palëve të CEFTA-s lejon prodhimin e produktit përfundimtar me çmime konkurruese, që u shitet klientëve të CEFTA-s pa tarifë doganore, por ai mund të mos jetë konkurrues në tregjet e tjera (për shembull, në BE dhe EFTA, duke qenë se kumulimi i plotë (ende) nuk zbatohet me to).

## 5.4 Shembull i kumulimit të plotë – rregulli i procesit/process rule

### PRODHIMI I FUNDEVE PREJ PAMBUKU (NK 6205) – me zbatimin e KP-së dhe DDB-së

Fijet kineze prej pambuku (NK 5205) importohen në Maqedoni ku enden në pëlhurë (NK 5208).

*RrSP-ja për NK 5208 mbështetet në të ashtuquajturin “rregulli i transformimit të dyfishtë”<sup>30</sup>, që do të thotë se, në situatën në fjalë, prodhimi duhet të ketë nisur nga fibra për të përmbushur listën e rregullave.*



Kjo nënkupton se pëlhura (NK 5208) nuk kualifikohet për origjinën preferenciale dhe ruan origjinën kineze.

Pëlhura joorigjinuese eksportohet nga Maqedonia në Moldavi, ku përdoret për të prodhuar funde (NK 6205). Eksportuesi maqedonas ka bërë një deklaratë furnitori për mallrat që i janë nënshtruar punimit në Maqedoni, pa u dashur të përftohet statusi i origjinës preferenciale.

*RrSP-ja për NK 6205 parashikon që procesi i prodhimit duhet të nisë me fillin dhe, më pas, produkti i përfunduar mund të përftojë origjinën preferenciale.*


Në Moldavi, këmishët e përfunduara përftojnë statusit e origjinës preferenciale, pasi punimi i kryer në Maqedoni i shtohet punimit të kryer në Moldavi për të prodhuar këmishë origjinuese. Kriteri i transformimit të dyfishtë në territorin e palëve përfiton nga kumulimi i plotë. Produkti përfundimtar përfiton origjinën preferenciale dhe mund të eksportohet në Palë të tjera CEFTA-s dhe përfiton nga trajtimi preferencial në to.

Megjithatë, duke qenë se kumulimi i plotë nuk njihet me Palë të tjera Kontraktuese të Konventës PEM, produkti nuk mund të riekportohet brenda zonës së PEM-it si preferencial.

Meqenëse mes Palëve të CEFTA-s zbatohet tërheqja nga detyrimi doganor, nuk është e nevojshme që kjo tarifë të llogaritet për të gjitha materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim, përpara sesa të lëshohet vërtetimi i origjinës ose detyrimi doganor mbi importet i paguar për materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim mund të rimbursohen.

<sup>30</sup>Rregulli i transformimit të dyfishtë nënkupton që dy procese të rëndësishme prodhimi duhet të zhvillohen në palën/zonën e MTL-së.

Foto 8. Kumulimi i plotë – rregulli i procesit



## 6 Vështrim i përgjithshëm – tërheqja nga detyrimi doganor

Termi “tërheqje” i referohet tërheqjes ose rimbursimit të detyrimit doganor mbi importin e materialeve të përdorura për prodhimin e një produkti për eksport.

### 6.1 Ndalimi i tërheqjes nga detyrimi doganor (rregulli i mostërheqjes)

Ndalimi i tërheqjes/rimbursimit ose i përjashtimit nga detyrimi doganor mbi importin parashikohet në shumicën e MTL-ve të lidhura midis vendeve partnere. Rregulli i mostërheqjes siguron pagesën e detyrimeve doganore të vendosura për materialet e vendeve të treta. Qëllimi kryesor për këtë është përjashtimi i dhënies së avantazheve të dyfishta doganore (mosmbledhja e detyrimeve doganore mbi materialet e një vendi të tretë në vendin e eksportit dhe importimi i mallrave shoqëruar me vërtetimin e origjinës, me normën preferenciale tarifore në vendin e importit).

Ndryshe nga DDB-ja, ndalimi i tërheqjes/rimbursimit favorizon përdorimin e materialeve nga zona e MTL-së, në vend të përdorimit të materialeve joorigjinuese nga vendet e treta.

#### 6.1.1 Konventa PEM dhe NDDB-ja

- ✓ Rregullat aktuale të Konventës PEM zbatojnë rregullin e përgjithshëm të ndalimit të tërheqjes nga detyrimet doganore për materialet e përdorura në prodhimin e çdo produkti (zbatimi i rregullit të mostërheqjes). Megjithatë, midis disa palëve Kontraktuese ofrohen përjashtime dypalëshe<sup>31</sup>. Objektivi i Nenit 14 të Konventës PEM është të parandalojë tërheqjen/rimbursimin për të gjitha materialet joorigjinuese të përdorura në punimin ose përpunimin e një produkti origjinues.

Kështu, duke qenë se këto materiale joorigjinuese janë subjekt i tarifave mbi importin, për të cilat, në të njëjtën kohë, nuk mund të ketë tërheqje ose rimbursim, në momentin e pranimit të deklaratës së riekportimit krijohet borxh doganor dhe përllogaritjet bëhen sikur materialet joorigjinuese të ishin hedhur në qarkullim të lirë. Qëllimi për këtë rregull është shmangia e diskriminimit negativ në trajtimin tarifor midis mallrat që janë për përdorim ose konsum vendas kundrejt mallrave të eksportuara në një vend partner.

- ✓ Palët Kontraktuese të Konventës PEM kanë propozuar, pas një analize të hollësishme, që, në kuadër të rishikimit të propozuar të Konventës PEM, rregulli i ndalimit të tërheqjes të eliminohet. Kjo mundësi duhet të shtrihet te të gjitha Palët Kontraktuese të PEM-it dhe te të gjitha produktet, me përjashtim të materialeve të përdorura për prodhimin e produkteve që përfshihen në objektin e Kapitujve 50 në 63<sup>32</sup> të NK-së.

<sup>31</sup>Vendimi 2/2017 i Komitetit të Përbashkët të Konventës PEM do të jetë pjesë e këtyre përjashtimeve.

<sup>32</sup>Rishikimi i propozuar i Konventës PEM përfshin edhe mundësinë për eliminimin dypalësh të NDDB-së për Kapitujt 50-63 të NK-së për produktet që kanë përfutur statusin origjinues, falë zbatimit të kumulimit të plotë dypalësh.



## 6.2 CEFTA dhe DDB-ja

Neni 10 i Vendimit 3/2015 të Konventës PEM shprehet se ndalimi i tërheqjes nga detyrimi doganor, parashikuar në Nenin 14 të Shtojcës I të Konventës PEM, nuk gjen zbatim në tregtinë dypalëshe midis Palëve të CEFTA-s.

Nëse mallrat përfundimtare përftojnë origjinën në Palën e CEFTA-s dhe eksportohen në një Palë tjetër të CEFTA-s, nuk është e nevojshme të paguhet tarifa doganore mbi materialet joorigjinuese të përdorura për prodhimin e tyre, përpara lëshimit të vërtetimit të origjinës ose të mundësohet rimbursimi i detyrimeve doganore<sup>33</sup>. Sidoqoftë, do të ishte e mundur që preferenca të jepej në Palën e CEFTA-s ku eksportohen mallrat.

Mundësia për të mos paguar apo rimbursuar detyrimet doganore mund të ndihmojë në zbatimin e rregullave të barabarta të lojës midis operatorëve ekonomikë në mbarë zonën e CEFTA-s. Kjo mund të përmirësojë konkurrencën, të reduktojë kostot dhe të shtojë tregtinë, pasi tarifat e larta mbi materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim i bëjnë MTL-të të mos kenë vlerë.

Kujtesë:

- ✓ Sipas Vendimit 3/2015 të CEFTA-s, ndalimi i tërheqjes nga detyrimet doganore nuk do të zbatohet në tregtinë dypalëshe midis Palëve të CEFTA-s.
- ✓ Sipas rishikimit të propozuar të Konventës PEM, sugjerohet që rregulli i ndalimit të eliminohet për të gjitha Palët Kontraktuese të Konventës PEM dhe për të gjitha produktet (me përjashtim të materialeve që përfshihen në Kapitujt 50 në 63 të NK-së).

## 6.3 Shembulli – rregulli i “mostërheqjes” kundrejt atij të “tërheqjes” nga detyrimet doganore

Informacion për kontekstin:

Profile prej alumini (NK 2606) dhe profile plastike (NK 3916) importohen nga Kina në BE, në përputhje me procedurën e regjimit të përpunimit të brendshëm. Norma e zakonshme tarifore për aluminin është 0%, por për profilet plastike është 6,5% (tarifa shtyhet për shkak të përpunimit të brendshëm).

- Përpunimi bëhet në BE për marrjen e produktit përfundimtar të profileve të aluminit (NK 7604).
- Këto profile alumini do të eksportohen më pas në Malin e Zi.

- Nëse RrSP-ja për 7604 (ex. CH 76 = CTH + maksimumi 50 % materiale joorigjinuese EXW) plotësohet, duhet lëshuar vërtetimi i origjinës për profilin e aluminit. Çfarë është DDB-ja?

<sup>33</sup> Shih dispozitat kombëtare.

Në vijim, paraqitet një krahasim i rasteve me NDDB<sup>34</sup> ose DDB<sup>35</sup>, me qëllim që të jetë më e lehtë të kuptohet ndikimi i DDB-së në produktin e përfunduar.


➤ **RREGULLI I MOSTËRHEQJES NGA DETYRIMI DOGANOR**

Neni 14 i Konventës PEM përcakton se materialet joorigjinuese (për shembull, alumini nga Kina + profilet plastike nga Kina) të përdorura për prodhimin e një produkti që e ka origjinën në një Palë Kontraktuese (BE), për të cilat është lëshuar ose bërë një vërtetim origjine, nuk u nënshtrohen në palën eksportuese tërheqjes ose përjashtimit nga asnjë lloj detyrimi doganor.

- Kjo nënkupton se, përpara lëshimit të vërtetimit të origjinës, krijohet borxh doganor për të gjitha materialet e përdorura në prodhimin e produkteve të eksportuara (të përlogaritura sikur mallrat joorigjinuese janë hedhur në qarkullim të lirë në treg) – mundësia 1.
- Ose eksportuesi mund të vendosë të eksportoje produktin përfundimtar pa lëshuar vërtetim origjine dhe, atëherë, borxhi doganor nuk shfaqet – mundësia 2.

Këto mundësi paraqiten në foton në vijim.

Foto 9 – Rasti kur zbatohet NDDB-ja



Kjo do të thotë se eksportuesi ka mundësi të vendosë të zbatojë tërheqjen nga detyrimi doganor dhe t'i shesë mallrat pa origjinë preferenciale, çka do të çonte në përlogaritjen e tarifës doganore në vendin importues; ose eksportuesi mund të paguajë një detyrim doganor mbi materialet të vendeve të treta të përdorura në prodhim dhe të lejojë marrësin në vendin partner të përfitojë nga preferencat tarifore mbi importin.

<sup>34</sup> Aktualisht, NDDB-ja parashikohet në Konventën PEM.


<sup>35</sup> E njëjta gjë do të bëhet e mundur në Konventën e rishikuar PEM.

## ➤ RREGULLI I TËRHEQJES NGA DETYRIMI DOGANOR

Nëse RrSP-në për NK 7604 plotësohet dhe përdoret mundësia e DBB-së, profilet e aluminit mund të importohen pa tarifë doganore në Malin e Zi, me vërtetimin e origjinës nga BE-ja. Në këtë situatë, materialet e vendit të tretë (CN) do të hyjnë në Malin e Zi pa paguar detyrimin doganor.

Përveç kësaj, ekziston edhe mundësia që profilet e aluminit të rihyjnë në BE dhe t'u jepet trajtim preferencial, në rastin e prodhimit në Malin e Zi (p.sh. dritare alumini) ku përdoren si materiale origjinuese (mundësia e kumulimit).

Foto 10 – Rasti kur zbatohet DDB-ja



## 6.4 Kumulimi i plotë dhe tërheqja nga detyrimi doganor

Kumulimi i plotë i jep secilës Palë Kontraktuese mundësinë për përdorimin e materialeve joorigjinuese, që janë përpunuar (më shumë se në shkallë minimale, por jo të mjaftueshme për të përfunduar origjinën) në një vend tjetër partner për prodhimin e produkteve për eksport. Të gjitha operacionet në dy (ose më shumë) Palë Kontraktuese do të merren parasysh kur të vendoset nëse produkti është në përputhje me dispozitat e parashikuara në Protokollin e Origjinës dhe nëse produkti përfundimtar ka përfunduar ose jo origjinën preferenciale.

Nga ana tjetër, tërheqja nga detyrimi doganor lejon, për rrjedhojë, mospagimin e detyrimeve doganore mbi materialet joorigjinuese të përdorura në prodhim.

Këto alternativa lehtësojnë përfundimin e origjinës për produktin përfundimtar dhe prodhimi mund të bëhet më efikas, falë mundësisë për përdorimin e lëndës së parë më të lirë, pa paguar detyrime doganore në prodhimin për eksport.

Më poshtë, paraqiten tri shembuj, që synojnë ta bëjnë më të lehtë të kuptohet ndikimi i KP-së dhe DDB-së në produktin e përfunduar në situatat në vijim:

- Kumulimi diagonal dhe NDDB-ja – situata aktuale në Konventën PEM;
- Kumulimi diagonal dhe NDDB-ja – rast hipotetik;
- Kumulimi diagonal dhe DDB-ja – mundësia në të ardhmen në Konventën e rishikuar PEM dhe Vendimi dypalësh 3/2015 i CEFTA-s.

Foto 11: Kumulimi diagonal dhe mostërheqja nga detyrimi doganor




Foto 12: Kumulimi i plotë dhe mostërheqja nga detyrimi doganor





Foto 13: Kumulimi i plotë dhe tërheqja nga detyrimi doganor



Ashtu siç tregohet në shembujt e mësipërm, zbatimi i kumulimit të plotë dhe DDB-ja ul shpenzimet e prodhuesit dhe krijon mundësinë e hedhjes në treg të një produkti më të lirë.

## **Anekset:**

1. Shtojca II – Pasqyra e lëndës – pas përfshirjes së Vendimit 2/2017
2. Instrumentet ekzistuese – faqet e internetit
3. Formati tip i deklaratës së furnitorit
4. Formati tip i deklaratës afatgjatë të furnitorit

# ANEKSI 1: Shtojca II – Pasqyra e lëndës pas përfshirjes së Vendimit 2/20177

## Shtojca II

### Dispozita të posaçme përjashtuese nga dispozitat e parashikuara në Shtojcën I

Pasqyra e lëndës

Neni 1

Neni 2

- ANEKSI I* Tregtia midis Bashkimit Evropian dhe pjesëmarrësve në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian
- ANEKSI II* Tregtia midis Bashkimit Evropian dhe Republikës Popullore Demokratike të Algjerisë
- ANEKSI III* Tregtia midis Bashkimit Evropian dhe Mbretërisë së Marokut
- ANEKSI IV* Tregtia midis Bashkimit Evropian dhe Republikës së Tunizisë
- ANEKSI V* Ceuta dhe Melilla
- ANEKSI VI* Deklaratë e përbashkët për Principatën e Andorrës
- ANEKSI VII* Deklaratë e përbashkët për Republikën e San Marinos
- ANEKSI VIII* Tregtia midis Republikës së Turqisë dhe pjesëmarrësve në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian
- ANEKSI IX* Tregtia midis Republikës së Turqisë dhe Mbretërisë së Marokut
- ANEKSI X* Tregtia midis Republikës së Turqisë dhe Republikës së Tunizisë
- ANEKSI XI* Tregtia midis shteteve të EFTA-s dhe Republikës së Tunizisë
- ANEKSI XII* Tregtia në kuadrin e Marrëveshjes së Tregtisë së lirë midis vendeve arabe të Mesdheut (Marrëveshja e Agadir-it)
- ANEKSI XIII* Tregtia që mbulohet nga Marrëveshja për Tregtinë e Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA), që përfshin Republikën e Moldavisë dhe pjesëmarrësit në Procesin e Stabilizim-Asociimit të Bashkimit Evropian
- ANEKSI A* Deklarata e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Evropian, Algjeri, Marok ose Tunizi, pa përfutur statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI B* Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Bashkimin Evropian, Algjeri, Marok ose Tunizi, që nuk kanë përfutur statusin e origjinës preferenciale

- ANEKSI C* Deklarata e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi, që nuk kanë përfutuar statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI D* Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në Algjeri, Marok, Tunizi ose Turqi, që nuk kanë përfutuar statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI E* Deklarata e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s ose në Tunizi, pa përfutuar statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI F* Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në një shtet të EFTA-s ose në Tunizi, pa përfutuar statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI G* Deklarata e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në palët e CEFTA-s, pa përfutuar statusin e origjinës preferenciale
- ANEKSI H* Deklarata afatgjatë e furnitorit për mallrat që i janë nënshtruar punimit ose përpunimit në palët e CEFTA-s, pa përfutuar statusin e origjinës preferenciale

#### *Neni 1*

Palët Kontraktuese mund të zbatojnë në tregtinë e tyre dypalëshe dispozita të posaçme përjashtuese nga parashikimet e përcaktuara në Shtojcën I.

Këto dispozita të posaçme përcaktohen në Anekset e kësaj Shtojce.

#### *Neni 2*

Mallrat që e kanë origjinën në Ceuta dhe Melilla, Andorra dhe San Marino trajtohen si produkte origjinuese në tregtinë diagonale, sipas parashikimeve të Nenit 3 të Shtojcës I, me kusht që në vendin e origjinës të jenë pajisur me një certifikatë EUR-MED apo të jetë lëshuar deklarata e origjinës EUR-MED.



## ANEKSI 2: Instrumentet ekzistuese – Faqet e internetit

Faqet e internetit të doganave të vendeve anëtare dhe kandidatë:

- ✓ [https://ec.europa.eu/taxation\\_customs/national-customs-websites\\_en](https://ec.europa.eu/taxation_customs/national-customs-websites_en)

Komisioni Evropian – Aspektet e përgjithshme të origjinës preferenciale

- ✓ [https://ec.europa.eu/taxation\\_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin\\_en](https://ec.europa.eu/taxation_customs/business/calculation-customs-duties/rules-origin/general-aspects-preferential-origin_en)

PEM – Manuali i përdoruesit:

- ✓ [https://ec.europa.eu/taxation\\_customs/sites/taxation/files/resources/documents/customs/customs\\_duties/rules\\_origin/preferential/handbook\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/taxation_customs/sites/taxation/files/resources/documents/customs/customs_duties/rules_origin/preferential/handbook_en.pdf)

PEM – Shënime shpjeguese

- ✓ <https://publications.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/123a0192-db5d-45cb-8a57-049576a66e86/language-en>

DG TRADE – Rregullat e origjinës

- ✓ <http://trade.ec.europa.eu/tradehelp/basic-rules>
- ✓ <http://trade.ec.europa.eu/tradehelp/duty-drawback>
- ✓ <http://trade.ec.europa.eu/tradehelp/cumulation>

ODB - Origjina

- ✓ <http://www.wcoomd.org/en/topics/origin.aspx>

ODB – Manuali i rregullave të origjinës:

- ✓ <http://www.wcoomd.org/en/topics/origin/overview/origin-handbook.aspx>

ODB – Paketa e përmbledhur e origjinës:

- ✓ [http://www.wcoomd.org/-/media/wco/public/global/pdf/topics/origin/instruments-and-tools/guidelines/origin\\_compendium.pdf?db=web](http://www.wcoomd.org/-/media/wco/public/global/pdf/topics/origin/instruments-and-tools/guidelines/origin_compendium.pdf?db=web)

OBD – Mjete dhe instrumente:

- ✓ <http://www.wcoomd.org/en/topics/origin/instrument-and-tools.aspx>

OBD – Baza e të dhënave të marrëveshjeve preferenciale të tregtisë dhe rregullave përkatëse të origjinës:

- ✓ <http://www.wcoomd.org/en/topics/origin/instrument-and-tools/database.aspx>

OBD – LEHTËSUESI I RREGULLAVE TË ORIGJINËS - kumulimi:

- ✓ <https://findrulesoforigin.org/Glossary/accum>

## SHTOJCA 3: Formulari i deklaratës së furnitorit

### Supplier's declaration

The supplier's declaration, the text of which is given below, must be made out in accordance with the footnotes. However, the footnotes do not have to be reproduced.

**SUPPLIER'S DECLARATION**  
**for goods which have undergone working or processing in the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey without having obtained preferential origin status**

I, the undersigned, supplier of the goods covered by the annexed document, declare that:

1. The following materials which do not originate in the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey have been used in the CEFTA Parties to produce these goods:

Description of the goods supplied <sup>(1)</sup>	Description of non-originating materials used	Heading of non-originating materials used <sup>(2)</sup>	Value of non-originating materials used <sup>(2)(3)</sup>
<b>Total value</b>			
<b>Total value</b>			

<sup>1</sup> When the invoice, delivery note or other commercial document to which the declaration is annexed relates to different kinds of goods, or to goods which do not incorporate non-originating materials to the same extent, the supplier must clearly differentiate them.

**Example:**

The document relates to different models of electric motor of heading 8501 to be used in the manufacture of washing machines of heading 8450. The nature and value of the non-originating materials used in the manufacture of these motors differ from one model to another. The models must therefore be differentiated in the first column and the indications in the other columns must be provided separately for each of the models to make it possible for the manufacturer of washing machines to make a correct assessment of the originating status of his products depending on which model of electrical motor he uses.

<sup>2</sup> The indications requested in these columns should only be given if they are necessary.

**Examples:**

The rule for garments of ex Chapter 62 says that non-originating yarn may be used. If a manufacturer of such garments in Serbia uses fabric imported from Montenegro which has been obtained there by weaving non-originating yarn, it is sufficient for the Montenegrin supplier to describe in his declaration the non-originating material used as yarn, without it being necessary to indicate the heading and value of such yarn.

A producer of iron of heading 7217 who has produced it from non-originating iron bars should indicate in the second column 'bars of iron'. Where this wire is to be used in the production of a machine, for which the rule contains a limitation for all non-originating materials used to a certain percentage value, it is necessary to indicate in the third column the value of non-originating bars.

<sup>3</sup> 'Value of materials' means the customs value at the time of importation of the non-originating materials used, or, if this is not known and cannot be ascertained, the first ascertainable price paid for the materials in one of the CEFTA Parties. The exact value for each non-originating material used must be given per unit of the goods specified in the first column.

2. All the other materials used in the CEFTA Parties to produce these goods originate in the CEFTA Parties;

3. The following goods have undergone working or processing outside CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey in accordance with Article 11 of the Convention have acquired the following total added value there:

Description of the goods supplied	Total added value acquired outside the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey <sup>4</sup>
(Place and date)	
(Address and signature of the supplier; in addition, the name of the person signing the declaration has to be indicated in clear script)	

---

<sup>4</sup> 'Total added value' shall mean all costs accumulated outside the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey, including the value of all materials added there. The exact total added value acquired outside the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey must be given per unit of the goods specified in the first column.

## SHTOJCA 4: Formulari i deklaratës afatgjatë të furnitorit

### Long-term supplier's declaration

The long-term supplier's declaration, the text of which is given below, must be made out in accordance with the footnotes. However, the footnotes do not have to be reproduced.

#### LONG-TERM SUPPLIER'S DECLARATION

**for goods which have undergone working or processing in the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey without having obtained preferential originating status**

I, the undersigned, supplier of the goods covered by this document, which are regularly supplied to .....<sup>1</sup> declare that:

1. The following materials which do not originate in the CEFTA Parties have been used in the CEFTA Parties, to produce these goods:

Description of the goods supplied <sup>(2)</sup>	Description of non-originating materials used	Heading of non-originating materials used <sup>(3)</sup>	Value of non-originating materials used <sup>(3)(4)</sup>
<b>Total value</b>			

2. All the other materials used in the CEFTA Parties to produce these goods originate in the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey;

<sup>1</sup> Name and address of customer.

<sup>2</sup> When the invoice, delivery note or other commercial document to which the declaration is annexed relates to different kinds of goods, or to goods which do not incorporate non-originating materials to the same extent, the supplier must clearly differentiate them.

**Example:**

The document relates to different models of electric motor of heading 8501 to be used in the manufacture of washing machines of heading 8450. The nature and value of the non-originating materials used in the manufacture of these motors differ from one model to another. The models must therefore be differentiated in the first column and the indications in the other columns must be provided separately for each of the models to make it possible for the manufacturer of washing machines to make a correct assessment of the originating status of his products depending on which model of electrical motor he uses.

<sup>3</sup> The indications requested in these columns should only be given if they are necessary.

**Examples:**

The rule for garments of ex Chapter 62 says that non-originating yarn may be used. If a manufacturer of such garments in Serbia uses fabric imported from Montenegro which has been obtained there by weaving non-originating yarn, it is sufficient for the Montenegrin supplier to describe in his declaration the non-originating material used as yarn, without it being necessary to indicate the heading and value of such yarn. A producer of iron of heading 7217 who has produced it from non-originating iron bars should indicate in the second column 'bars of iron'. Where this wire is to be used in the production of a machine, for which the rule contains a limitation for all non-originating materials used to a certain percentage value, it is necessary to indicate in the third column the value of non-originating bars.

<sup>4</sup> Value of materials means the customs value at the time of importation of the non-originating materials used, or, if this is not known and cannot be ascertained, the first ascertainable price paid for the materials in one of the CEFTA Parties. The exact value for each non-originating material used must be given per unit of the goods specified in the first column.

3. The following goods have undergone working or processing outside CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey, in accordance with Article 11 of the Convention have acquired the following total added value there:

Description of the goods supplied	Total added value acquired outside the CEFTA Party, [the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey]; <sup>5</sup>
	Total value:

This declaration is valid for all subsequent consignments of these goods dispatched from.....

to.....<sup>(6)</sup>.

I undertake to inform.....<sup>(1)</sup> immediately if this declaration is no longer valid.

.....  
*(Place and date)*  
 .....  
 .....  
 .....

*(Address and signature of the supplier; in addition, the name of the person signing the declaration has to be indicated in clear script)*

<sup>5</sup> Total added value' shall mean all costs accumulated outside the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey, including the value of all materials added there. The exact total added value acquired outside the CEFTA Parties, the EU, the Faroe Islands, Iceland, Norway, Switzerland (including Liechtenstein) or Turkey must be given per unit of the goods specified in the first column.

<sup>6</sup> Insert dates. The period of validity of the long-term supplier's declaration should not normally exceed 12 months, subject to the conditions laid down by the customs authorities of the country where the long-term supplier's declaration is made out.